

BIBLIOTEKA
SHTETIT

8JH-2

R 48

JOSIP
RELA

NITA

DRAME

814-2
R 48

JOSIP RELA

NITA

Dramë në katër akte

Përshtatur në shqipen letrare nga
SAMI ÇABEJ



19798

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

P A R A T H È N I E

Josip Rela (1895-1966) lindi në katundin Arbëresh, në Zarë të Dalmacisë, prej prindësh me origjinë nga shqiptarët e mërguar në vitet 1726, 1729, 1733 nga Malësia e Shkodrës, prej katundeve Brisk, Shestan e Zjare. Arësyet dhe rrëthanat që i detyruan ata shqiptarë të shpërngrueshin prej trojeve të të parëve dhe të vendoseshin në afërsi të Zarës, në kohën e pushtimit të egër turk, Rela i ka shpjeguar nëpërmjet dramës «Nita».

Mësuesi i dikurshëm i Rabit, Vinjercit, Zarës, Kastel Novos e Sllatinës e, më vonë, i Plavës, Gucisë, Priftajt e Trieshtit, mësuesi i parë i shkollave shqipe në këto anë, drejtori i mëvonshëm i Teatrit populor të Zarës dhe i shkollës normale, Josip Rela është autor i dramave «Kungulli», «Dila», «Fisi i mallëkuom», «Tallasat e Dybjës», «Zani i fëmiut», «Ik, Jak, ik», etj, i komedive «Deri në tetë ditë», «Provat», i melodramës «Martesa» dhe i një tufë vjershash.

Vepra dramatike e Relës është e shumëllojshme për nga tematika e subjektet që trajton. Dramat e komeditë kanë në qendër të vet rrjedhën e ngjarjeve historike dhe ndikimin e tyre në jetën e arbëreshëve të Zarës, ngjarje këto që datojnë prej ditëve më të hershme, kur bashkëvendasit e Relës u dety-

ruan të braktisnin trojet e të parëve për të kërkuar strehim në brigjet e largëta të Adriatikut e shkojnë gjer në vitet pas çlirimt nga pushtuesit fashistë.

Vepra, që e bën plakun e Zarës më të njohur, sikur edhe e vetme të qe, është drama me katër akte «Nita». Kjo dramë, shkruar me pathos e forcë dramatike, është jehonë e fatit të rëndë të malësorëve të Veriut pas pushtimit të Shqipërisë nga turqit. Autori, jo vetëm e njeh mirë epokën në të cilën vendos ngjarjet, por njeh mirë dhe depërtton në shpirtin e këtyre njerëzve të thjeshtë, bujarë e trima, të cilët asnijëherë nuk iu nënshtruan armikut të egër. Edhe pasi largohen nga atdheu, të detyruar nga rrethanat e vështira, ata ruajnë të pacënuara zakonet e të parëve, traditat, doket, mënyrën e jetesës. Fryma patriotike përshkon veprën tejembanë. Asnjëherë këta njerëz të thjeshtë nuk shkulin nga zemrat dhe mendjet e tyre ndjenjat dhe kujtimet nga vendi ku kanë «varret e të parëve».

Kjo është njera ide, patriotizmi, mbi të cilën është ndërtuar vepra. Por qëllimi i autorit synon më tej. Malësorët qëndrojnë besnikë ndaj traditave të të parëve, por, thotë autorri, koha në lëvizjen e saj përrpara i filtron këto tradita e zakone, shtron kërkesën për të mbajtur ato më të mirat, pasi vjen një ditë që shumë prej tyre bëhen të pavlefshme, të vjetëruara e, për pasojë, të dëmshme. Në këtë mënyrë koncepti i dramës vjen e zgjerohet, marrin jetë fenomene dhe aspekte të rëndësishme shoqërore e morale, duke e thelluar kështu përbajtjen e saj realiste.

Përmes figurave që lëvizin nëpër skena të ndryshme ai, jo vetëm i shtron dhe i rreh gjerësisht këto, por edhe i zgjidh në bazë të normave më të reja që koha i nxjerr për t'ua zënë vendin të vjetëruarave.

Sintezë e ideve të autorit është gjyqi i Nitës. Aty kryqëzohen e mpleksen me dramacitet qëndrimet më të ndryshme ndaj çështjes së kësaj vajze të thjeshtë, ashpërrohet konflikti, ndeshet për jetë a vdekje e vjetra me të renë. Fjala e zjarrtë e Luk Kapetanit me argumenta të pakundërshtueshme dënon pikëpamjet e vjetëruara të Markut, Jakut, priftit e pleqve të tjerë mbi zakonet. Nuk do të ishte i drejtë gjykimi i personazheve, në lëvizjen e tyre dramatike, të grupuara në moshë apo breza etër-bij. Përkundrazi, autori i është larguar këtij konceptimi e, për këtë, ideja fiton më tepër forcë. Ndonëse pleqtë gjykues janë të gjithë blok dhe të rinxjtë, nga ana e tyre, kundërshtojmë me mendje e zemër gjykimin dhe vendimin e pleqve, nuk mund të radhisim në anën e këtyre as Ithën, që më tepër është e moshuar, se e re, as Lukën, këtë karakter të fuqishëm e burrëror. Në këtë mënyrë drama thellon bazën e vet realiste, ndonëse në tërësi ndihen në të tone romantike.

Ideja e Lukës fiton, gjykimi i masës del triumfues e pleqtë tërhiqen. Kjo është edhe ideja më e rëndësishme e dramës, e cila buron natyrshëm, në përputhje me fryshtën e saj, me rrëthanat dhe bren-dinë e personazheve. Ndonëse vetëvrasja e Nitës, e parë në mënyrë më të drejtpërdrejtë, mund të tingellojë pak si e nxituar, nga ana tjeter, së brendshmi, ajo lidhet ngushtë me idenë bazë të veprës, se zakonet e vendit të saj janë të vrazhdë, nuk falin. Vetë Nita nuk është krejtësisht e shkëputur nga ato dhe, në një farë mase, ajo është pjellë e tyre, ajo e di se, edhe pa faj, është e dënuar dhe këtë dënim ajo vendos ta zbatojë me dorën e vet, pa u penduar për veprimin që kreu në ato rrëthana. Thjeshtësia dhe pastërtia morale e saj, krenaria dhe bindja se ka ve-

pruar drejt për të mos cënuar harmoninë dhe dashurinë shoqërore — motivi më i lartë — nuk e çojnë atë të kërkojë falje nga gjyqi i pleqve, përkundrazi ajo proteston ndaj tij. Kulmi i kësaj proteste është vetëvrasja. Ky akt e forcon protestën, duke dënuar edhe më rëndë vetë gjyqin — rezultat i presionit të patriarchalizmit dhe i kishës. Akti vetë është në përputhje me rrethanat, është jehonë tragjike e së vjetrës që po përpelitet. Ky moment nuk duhet parë si efekt i jashtëm emocional, por, përkundrazi, si një mjet i fuqishëm ideoartistik që tregon në mënyrë të gjallë se ato zakone janë të ashpra, dhe antihumanitare dhe duhen shkallmuar. Në këtë moment zbulohet qartë qëndrimi mohues i autorit jo vetëm kundër këtyre zakoneve patriarkale, por edhe kundër kishës e klerit katolik si mbështetje e fuqishme e këtyre zakoneve. Dhe këtu qëndron vlera më përparrimtare e kësaj vepre.

Drama është shkruar me fryshtësim dhe dashuri të madhe ndaj këtyre njerëzve që u detyruan të braktisin atdheun në ato kushte të vështira historike. Autori ka merita në thurjen e skenave të gjalla, në mprehjen e dialogut, në dinamizmin dhe harmoninë e veprimeve, në paraqitjen e tablove masive. Zakonisht çdo personazh ecën në profilin e vet, vizatohet në profilin e vet e, në këtë ansambël të gjerë, spikat harmonia e figurave, e ndjenjave dhe e mendimeve e, përmes tyre, gjithmonë në rritje, ashperosohen kontradiktat që e kanë zanafilën në botën social-psikologjike të këtyre njerëzve, në përputhje me frymën e kohës.

Autori zbulon ndjesitë më delikate të këtyre njerëzve, futet në shpirtin e pastër të të rinjve e, në këtë mënyrë, e gjithë vepra flladitet nga një fryshtë

e freskët lirizmi. Jo vetëm nga dialogët e ngrohtë të të rinjve, nga shakatë e romuzet e tyre, por edhe nga thurja e skenave intime, nga shpalosja e ndjenjave, pikëzimi i momenteve, apo edhe nga frysma e përgjithshme e ambjenteve piktoreske, duket sikur burojnë tinguj të ëmbël lirikë që flasin për jetën, gëzimin, dashurinë. Ky lirizëm është dhënë me mjaft efikasitet në funksion të ntrashjes së ngjyrave në kontrast me kanunin e egër.

Nita është figura më e realizuar e dramës. Njomështia dhe freskia e ndjenjave, shpirti delikat dhe njëkohësisht i fuqishëm, dashuria e saj e pamasë për Zefin, babanë, shokët e shoqet, trimëria dhe besnikëria ndaj fjalës së dhënë, gëzimi i jetës, shpirti i sakrificës, gjithë këto e të tjera tipare të botës së saj janë mishërim i gjallë i veticë të femrës shqiptare. Ndonëse autori i thellon ngjyrat e ngrohta në portretin e saj, gjë që forcon një notë idealizimi të figurës, përsëri ajo mbetet figurë e plotë tërësore, në përputhje me rrethanat.

Në tërësinë e saj, drama, për nga paraqitja e rrethanave dhe karaktereve që veprojnë në të, është realiste, ndonëse me tone të forta romantike. Dramacitëti i saj buron nga vetë gjendja shoqërore e psikologjike e karaktereve. Ndonëse pleqtë tërhiqen pak si shpeit nga argumentat e Lukës, pra si pak me lehtësi heqin dorë nga gjykimi dhe vendimi i tyre, përsëri kjo gjë nuk e mohon realizmin e dramës në frysmin e saj të përgjithshme. Ky moment përligjet nga qëllimi i autorit, që është dënim i zakoneve të vjetëruara. Megjithatë ideja përçohet mjaft mirë tek lexuesit, i cili, qiatë qjithë skenave, ndiek me simpati fatin e heroinës dhe asnijëherë nuk dënon pleqtë si bartës të zakoneve të egra, por vetë këto zakone.

Sami Çabej

V E T A T

PRENK VUKA		vjeç	44
NITA, e bija		vjeç	17
ZEFI I UCIT		vjeç	21
GJONI I SKËNDERIT		vjeç	60
MARKU I UÇIT		vjeç	62
JAK PERAJ	pleqtë	vjeç	58
DASHI I PALIT	gjykues	vjeç	52
LUK KAPETANI		vjeç	48
ITHA, e shoqja e Gjonit		vjeç	52
CANA, e bija e Markut, milkeshë e Nitës		vjeç	18
ROZA, e bija e Nik Lukës		vjeç	17
PALI i Jak Perajt		vjeç	22
NIKU i Dash Palit		vjeç	23
MIMQI I Gjonës		vjeç	24
PRIFTI		vjeç	42
GJOVALIN KRISTOFOLI, guvernator i arbëreshëve			
		vjeç	46

Burra, gra, djem, vajza, fëmijë

Koha e ngjarjes

Akti i parë: në Brisk, më 1726

Akti i dytë: në Arbënesh, më 1729

Akti i tretë: në Arbënesh, tre muaj më pas

Akti i katërt: në Arbënesh, dy muaj më pas

A K T I I

Udhëkryq në Brisk (*në krahinë të Shkodrës*). Në njërën anë një shtëpi me mure të thatë, me derë në mes. Në anë të derës ka një ballkon të vogël, të ngushtë. Pranë shtëpisë një kasolle për bagëti me derë të hapur. Para shtëpisë oborri i rrethuar me mur të ulët. Në anën tjetër edhe një shtëpi si kjo. Pas tyre shihen të tjera shtëpi, të shtrira në faqe të malit. Është fillimi i pranverës. Dëgjohen blegërima dhensch e ndonjë tingull këmbore. Herë-herë, dëgjohet pëllitja e lopës. Me kalimin e kohës gjithnjë e më pak dëgjohen tingujt që lëshojnë bagëtitë e nata shtrihet.

Kur hapet skena, dëgjohen diku larg pesë-gjashtë krisma kobureje.

PAMJA E PARE

Zefi, Nita, Prenk Vuka, Mimqi, Niku, Pali,

Cana, Roza.

Të gjithë vijnë pas Zefit, gra e fëmijë.

ZEFI — (*Duke mbajtur me dorën pas qafe Nitën gjysmë tē zhveshur, tē mekur e lëshon ngadalë nē mur. Ulet pérpara saj e me zë tē ulët i flet.*): Nita, Nita! Ja, këtu je, nē shtëpinë tënde, nē fshatin tënd! Të kemi shpëtuar prej rrezikut!... (*Të gjithë afrohen dhe e shikojnë Nitën me çudi*)

NJË GRUA: Shiko, Zef, se është e mekur.

E DYZA — Ujë, ujë! Bini ujë!

ZEFI — Vraponi! Bini! Vraponi shpejt!

CANA — (*duke vrapuar nē shtëpi tē Nitës pér ujë*)
Ika!

NJË GRUA — Largohuni! Ç'jeni mbledhur ashtu!

E DYZA — Ajër, i duhet ajër! (*I çliron brezin e parzmat*): Largohuni prej saj, kur ju thonë.

CANA — (*Kthehet me një ibrik me ujë, rri pas murit dhe e stërpik Nitën.*)

NJË GRUA — (*duke freskuar Nitën me një erashkë*):
Tani ka pér tē ardhur nē vete...

NITA — (*duke ardhur nē vete...*) Ku jam këtu?..

ROZA — (*I vë dorën pas kokës*): Nita!.. Nita!

FËMIJËT — Po ngjallet! Po ngjallet!

ZEFI — Këtu je Nita, këtu! Këtu nē shtëpinë tënde...

ROZA — Nita ime, si ndjehesh?...

GRATE — E shkreta! E shkreta!

FËMIJËT — Gjallë është, gjallë!

NITA — (*Çohet ngadalë nē këmbë e shikon rreth vetes*): Roza!.. Cana!... (*grave*): Jo, nuk jam e shkretë kur jam këtu... Po si ndodhi që po gjendem këtu?.. Kush më çliroi?.. Kujt i detyrohem pér këtë?..

PRENKA — Nita, lulja e babës! Shikoi mirë këta të rinj... Sapo dëgjuan se të kishin grabitur, të

katër kërcyen si trima pas grabitqarëve, i
ndoqën, gjersa të çliruan.

NITA — Faleminderit të gjithëve...

NIKU — Po, Nita, të gjithë u turrëm të të çlironim,
por Zefi është ai që na dha guxim e shpresë.

MIMQI — Po, pasha zotin, ashtu është. Ai u hodh
në kalë pas shërbëtorit të beut, ja preu fy-
tin, të mori në krah e iku me ty...

PALI — Gjersa u bashkuam me dy të tjerët, edhe
unë vetë çuditem si s'e zuri ndonjë kokërr
plumbi...

ZEFI — Nita, asgjë s'kam bërë më shumë se këta
trimat këtu!

NITA — Faleminderit trima! Ju falenderoj nga zemra
për trimërinë e nderin tuaj!.. Por tani, ju
lutem, më lejoni të shkoj në shtëpi!...

ZERA — Shko, shko. Pusho pak. Shtrihu një grimë
në shtrat...

NITA — (*Shkon në shtëpi, pas saj Cana e Roza*)

PAMJA E DYTE

(Të parët pa Nitën, Rozën e Canën)

NJË GRUA — E mjera vajzë, e kanë munduar...

E DYZA — Kush donte ta grabiste?

MIMQI — Shërbëtorët e Aqim beut qenë...

GRUAJA — Pika i rëntë atij e gjithë atyre grabit-
qarëve..

PALI — Të dielën ja shpunë një vajzë nga Livari.

E DYZA — Na grabisin vajzat e fëmijët, na grabisin
bulken e bagëtinë.

NIKU — Kur ndodh kështu, askush s'na jep dorën.

GRUAJA — Ju lumtë, trimave, që u treguan dhëmbët...

ZEFI — Po, po. Duhej t'i mbysnim të gjithë, t'i shkelnim. Të gjithë këta agallarë, bejlerë, pashallarë sado të jenë...

PRENKA — Po, duhej, duhej. Po janë shumë, janë të fuqishëm: kanë xhandarët, ushtarët, kanë armët... Lufta me ta s'ishte e barabartë... Na digjnin fshatrat, na vrisnin fëmijët, gratë.

NJE FËMIJË — Ja, po vijnë pleqtë!

PRENKA — Mirëse po vijnë. Ju, fëmijët, shkoni tanë në shtëpi. (*Fëmijët shkojnë. Grave*): Edhe ju gratë, na lini të flasim me pleqtë. (*Gratë ikin.*)

PAMJA E TRETE

Të parët, pa gra e fëmijë, Gjoni, Dashi, Marku e Jaku.

PRENKA — Mirë se vini, pleq! (*Të rinjtë u bëjnë vend në mur*)

PLEQTË — Mirë se ju gjejmë! Mirë se ju gjejmë! (*Ulen në mur*)

MARKU — (*Të rindje*) Na tregoni ju, të rinjtë, si ndodhi kjo punë...

PALI — Kur na tregoi Zefi se Nitën e grabitën, u hodhëm në kuaj, u premë udhën... Filloi lufta... Zefi u hodh me kalë pas shërbëtorit të beut.. ja preu fytin... tjetrin e vramë dhe i treti iku.

DASHI — Mirë, po a keni menduar ç'mund të ndodhë tashti?

MIMQI — Mos na thoni tashti se duhej t'i lëshonim të bënин ç'të donin e si të donin...

JAKU — Jo, djem, jo! Ju keni bërë si ç'do të bënин edhe baballarët tuaj, po të qenë, por...

NIKU — Ne bëmë atë që na tha zemra. Tani na tregoni se ç'duhet të bëjmë më tej.

GJONI — Thatë se njëri prej tyre shpëtoi?

PALI — Po, njëri prej tyre iku, s'mundëm ta kapnim.

MARKU — Ky ka për t'i treguar Aqim beut! Agim beu është mik i Asllan Pashës...

GJONI — Nesër, ose, shumë-shumë, pasnesër, Aqim beu na rrëthon fshatin me ushtarë.

DASHI — Na shuan fshatin, ne na bën robër dhe na vë në hu..

NIKU — Ne nuk jepemi!

MIMQI — Edhe ne kemi pushkë e kobure!

JAKU — Dhe, ju duket se mund t'i qëndroni, kështu, ushtrisë?

PALI — Ne do të mbrohemë sa të mundim.

ZEFI — Trimat në luftë vdesin!

PRENKA — Më falni, le të them edhe unë fjalën time.

MARKU — Folë, Prenk, folë.

PRENKA — Ky hali ju kapi nga unë dhe nga shtë-pia ime. Mendoj se më duhet të iki këndejej. Mundet që, Aqim beu, nuk e merr gjakun në fshat, po të mos jetë Nita ndërmjet jush...

MARKU — Më duket se s'e zgjidhe mirë, Prenk.

GJONI — Aqim beu tani e ka më shumë me këta se sa me ty...

JAKU — Ashtu, pra. Aqim beu e merr gjakun më

parë te ata që ja morën gjakun dhe ata janë këta të rinjtë tanë.

DASHI — Ne jemi, pra, fajtorët e parë! Fshati mund ta lajë këtë gjak vetëm duke dorëzuar fajtorët në dorë të tyre.

PRENKA — Atëhere, ne s'kemi si e zgjidhim ndryshe, por...

DASHI — Ç'deshe të thoshje?

PRENKA — Të gjithë ata që janë përzier në këtë gjak, të ikin këndeja, t'i lenë këto anë, të zhduken...

MARKU — Kjo është më e mënçur, Prenk.

JAKU — Ne kështu e kemi dhënë fjalën, të iket këndeja, të iket prej këtij zullumi, me det, ku merret frymë më lehtë...

DASHI — Tani s'na mbetet gjë tjetër, veçse të ikim! Më mirë të ikim sot, se sa një ditë tjetër, siç kemi dhënë fjalën...

JAKU — Sot, po. Sonte! Nesër mund të jetë vonë. Prandaj: Sonte! Mos humbasim kohë, vëllezër, s'pret puna për fjalë! Ata që do të mbeten këtu, le t'i thonë Aqim beut dhe miqve të tij: «Fajtorët kanë iku!»... Kështu?

MARKU — S'ka rrugë tjetër!

GJONI — Mirë, pra. Japim besën?

TË GJITHË — Betohemi! Betohemi! Betohemi!

JAKU — Në dashtë ndokush të vijë sonte me ne, mire se të vijë..

MARKU — Duhet të bëhem i gati shpejt... S'kemi shumë kohë.

DASHI — Kur të ndihen gjelat e parë, të nisemi!
(çohet të ikë)

GJONI — Me gjelat e dytë të gjendemi në breg të zogjve!... (çohet)

MARKU — Ju, të rinjtë, lajmëroni të tjerët, mbase duan të bashkohen me ne.

DASHI — Të bëhemë gati, vëllezër! (*Ikin ai dhe Gjoni.*)

JAKU — Shkojmë! Në dorë të Zotit! (*Shkojnë ai dhe Marku. Të rinjtë akoma diçka thonë nën zë e ikin dhe ata. I fundit ikën Prenka në shtëpi.*)

PAMJA E KATËRT

(Vetëm Zefi)

ZEFI — (*duke menduar*)... Të ikim... sonte të ikim... Po unë? Ç'të bëj unë? Babai akoma s'është kthyer nga Shestani!.. Çudi e madhe, si s'u kthy... Do t'i ketë ndodhur ndonjë gjë... Dreqi i bije punët tamam ashtu, për të të thyer fatin! (*Nervoz*): Babë, o babë, ç'të ka ndodhur? Pse s'më çove ndonjë lajm?.. O, i ziu unë! O, sa i shkretë jam!.. Sonte po shkojnë!.. Dhe Nita po shkon!.. Përse s'më mori dreqi?! Pse s'më kapi ndonjë plumb, më mirë!.. Ç'të bëj, çfarë!?

PAMJA E PESTË

Zefi, Cana e Roza dalin nga shtëpia

CANA — (*nga dera, Nitës*) Mirë mbeç, Nita, gjersa të shihemi!



1984
19298

ROZA — (*nga dera, Nitës*): Mblidh forcat, Nita, e bë—
hu gati shpejt!

ZEFI — (*me vete*): Edhe këto të dyja po shkojnë!..
O, zot!

CANA — (*Rozës*): Shkojmë, shpejtohem, Roza. Shu—
më punë po na pret.

ROZA — (*duke vajtur*): Nuk di, a do të mundë ta
durojë udhën kështu e dërmuar siç është?

CANA — Nevoja i jep njeriut fuqi. (*Shikojnë Zefin*):
O, Zef! Po pushon?

ZEFI — Po pres babën...

ROZA — E ku është baba?

ZEFI — (*ashpër*): Në dreq!

CANA — I zemëruar je, Zef!

ZEFI — I zemëruar, i fryrë, i tërbuar më shumë se
të gjithë dreqërit bashkë!

ROZA — Për besë, s'më ka shkuar ndër mend se
mund të bëhesh kështu.

(*Ikin*)

PAMJA E GJASHTË

Zefi e Prenka

PRENKA — (*nga dera, Nitës*) Si të kam thënë, Nita!
Në dy thasë. Atë me të ngrëna vure në tor—
bë... Unë po shkoj dy-tri minuta te Luk
Niika. Mos e le shtëpinë vetëm... (*Kthehet në
shtëpi, del përsëri me kobure, e vëren, e
ngjesh në brez e i thotë Nitës*): Ashtu si të
kam thënë, Nita! (Del jashtë oborrit)

ZEFI — Prenk Vuka!...

PRENKA — Zef, ti je? Mirëmbrëma!

ZEFI — Mirëmbrëma, po s'më erdhi mirë mbrëmja,
Prenk Vuka... Më ka ardhur aq e keqe sa
s'di ç'të bëj...

PRENKA — Pse ashtu, Zef? Ç'të ka ndodhur?

ZEFI — Qysh në mëngjez baba ka shkuar në Shes-
tan e ende s'është kthyer.

PRENKA — Pse ka vajtur në Shestan?

ZEFI — Ka vajtur të marrë paret. Atje ka dhënë disa
dele dhe akoma s'është kthyer.

PRENKA — Përgatit teshat, Zef, në dy pjesë, le të
jenë gati të gjitha dhe prit...

ZEFI — Lehtë është t'i bësh gati teshat, por...

PRENKA — Yt atë di ç'bën. Ka ende kohë. Prift
babën...

ZEFI — Zemrën s'e kam të qetë. S'zë vend kurrikund,
sikur të kisha dikë në arkivol...

PRENKA — Paç shpresë, Zef, e prit. — Unëtpo
shkoj tek Luk Nika (*Ikën*). — *Unëtpo*

— ATIK

ATIK

ATIK

ATIK

ATIK

PAMJA E SHTATE

Zefi e Nita

ZEFI — (*Ulet në mur. Mbështet kokën te dora*):
Babë, o babë, ku je?... Ç'të bëj pa ty?... Te
pres akoma, të pres?... Oh!

NITA — (*Nga dera*): Zef, ti je? Ç'bën aty?

ZEFI — Nita?!

NITA — Zef, ç'të ka ndodhur, Zef?

ZEFI — Të humba, Nita, të humba!...

NITA — Ç'po thua, Zef? Po shkojmë, po ikim.
Bashkë do të ikim, Zef! Ç'të ndodhë, le të
ndodhë, vetëm bashkë të jemi.

ZEFI — (*Duke u ngritur*): Nita, Nita! Zemra më
është këputur. S'di ç'të them, s'di ç'të bëj...

NITA — (*e çuditur*): Ç'po thua kështu, Zef? Ç'të ka
ndodhur?

ZEFI — Nita, zemra ime! Nita...

NITA — (*e çuditur*): Po, Zef, po. Jotja, jam jotja.
Jotja me mend, me zemër, me shpirt. Por,
s'po i kuptoj fjalët e tua... Ç'të ka gjetur?
Më trego, Zef!

ZEFI — (*duke marrë frymë thellë*): Nita,... baba
ende s'më ka ardhur... Në mëngjez herët ka
vajtur në Shestan dhe s'ka ardhur... Kam
frikë, Nita, se të lë, se të humbas...

NITA — Pse do më lesh? Përse do më humbasësh?

ZEFI — Shiko, Nita! Në mos ardhtë sonte baba... Në
mos pastë kohë të bashkohem me të tjerët...

NITA — (*e trembur*): Jo, jo Zef! Mos e thuaj atë!
Mos mendo ashtu, keq!.. (*I shtie dorën në
krah*): Paç shpresë, Zef! Do të vijë baba... O,
Zef! Mos ma tremb zemrën më shumë se
ç'është trembur!

ZEFI — Nita, vajzë e dashur! Nita,jeta ime!.. Frika
e vdekjes më kap duke menduar se mund
të të lë... (*E merr për dore*).

NITA — Jo, jo, Zef! S'mund të jetë perëndia aq e
keqe!..

ZEFI — Lulja e jetës sime! (*E afron në gjoks*): Da-
shuria ime!...

NITA — As unë s'kam jetë pa ty, Zef!..

PAMJA E TETË

Zefi, Nita dhe Itha

ITHA — (*vjen udhës, duke i parë*): Shih, shih, dre-qi!.. Edhe këtu, tek ne kanë filluar si të mëdhenjtë. (*Kur u afrua*): O, ju dy zogjtë jeni? Besa, mirë po mendoni në rrugë... O, o, keni për të pasur kohë kur t'i thoni njëri-tjetrit atë që keni në zemër. A jeni bërë gati? Teshat janë në vend? Për një orë duhet të nisemi... Kur të dëgjoni gjelat e parë... «Bregu i zogje».

NITA — Itha, të lutem, mos trego se na ke parë.

ITHA — O, o, s'ju kam parë unë... Qielli dhe yjtë ju kanë parë...

ZEFI — Qielli, qielli! Kur të më shikonte kështu qielli gjer në vdekje!...

ITHA — Shiko, kjo! E kapi flaka, si pisha kur ndizet, e tani s'shqitet dot... Ç'doja të thoshja? Po. Keni dëgjuar? Në Shestan kanë qenë ushtarë sot... kanë mbledhur pér luftë në Persi këdo që kanë kapur... E ju këtu...

ZEFI — O, baba im i dashur!.. O, i mjeri unë!...

ITHA — O, i mjeri djalë, ç'pate prapë?

NITA — Itha, lere Zefin.... Baba s'i ka ardhur ende... Ka shkuar në Shestan qysh në mëngjez...

ITHA — O, më fal, më fal!... Po kemi dhënë besën.
— Por, si kështu atëhere? — Fémijët e mi, nuk kemi kohë pér të humbur... Po bije nata. Duhet të mendojmë pér rrugë... Kam pér të parë edhe disa të tjerë që janë vënë në ikje... (*Shkon*)

PAMJA E NËNTË

ZEFI — Pse s'vdiqa kur të shpëtova nga dora e Aqim beut? Pse s'më mori mortja?.. Pse...

NITA — (*duke u lutur*): Zef, mos folë asi marrëzirash? Mirë që jemi të gjallë... Të rinj jemi, Zef... Kemi dashurinë tonë.

ZEFI — O, Nita, Nita! Tamam kjo dashuri ma mbushi shpirtin me helm, sepse, po të mos kisha në zemër këtë dashuri, s'më dhimbte asgjë, po të mos shkoja me ju...

NITA — Zef, unë kam aksoma shpresë se baba do të l'kthehet në kohë..

ZEFI — Tashmë të gjitha shpresat më kanë humbur... Të paktën të dija ç'u ka ndodhur... Po të kishte vdekur, a të ishte vrarë, atëhere do të dija ç'të bëja. Kështu...

NITA — Në mos shkofsh ti, Zef, do ta lus babën të mos shkojë as ai...

ZEFI — E embla vajza ime! Njerëzit e kanë dhënë fjalën, e kanë dhënë besën... Në rast vdekujeje, të ndonjë sëmundjeje të rëndë, ose kur nuk shihesh me njerëzinë tënd si ndodhi tanë me mua, mund të falet besa, ndryshe kurrsesi, Nita.

NITA — (*me zë të vrarë*): Atëhere, Zef, si të shkoj pa ty? Edhe unë do të rri me ty.

ZEFI — O, sa bukur do të qe, po të ishte kështu! Por, mos më vra edhe më shumë se ç'jam... Ajo s'mund të ndodhë kurrsesi!.. Ty të duhet të shkosh!... E në humbsha kokën, në humbsha dashurinë, nuk dua, Nita, të hum-

bas faqen! — Jo, Nita, jo. Ti, shko! Unë vij pas teje! Pas teje vij, Nita, ose vdes!

NITA — (duke qarë): Zef, në shkofsha, kudo që të jem, të pres!

ZEFI — O, lulja ime eëmbël! (E merr në gjoks... dëgjon zërat). Ikë tani, shko! Shko në shtëpi. Shikomë edhe një herë... (Nita shkon duke qarë në shtëpi dhe Zefi në shtëpi të vet)

PAMJA E DHJETË

Vijnë Prenka, Gjoni e Marku

MARKU — ...Ashtu i bijem «Qafës së Malit», presim «Bregun e Dushkut» pas Pashtroviqave dhe e kalojmë kufirin afër «Greblastit të Stanit» dhe bijem në Lastov...

GJONI — Duke menduar se kemi fëmijë, gra e teshë, sa kohë mund ta bëjmë rrugën?

MARKU — Ti e di vetë se nata është, si të thuash, e rrumbullaktë e pa sy... Duke kaluar ditën, ashtu lirisht, do të na mjaftonin nja pesë-gjashtë orë. Kështu, kujto, do të na duhet dy herë më shumë, por na duhet që nesër të kalojmë ditën në «Bjeshkë të Qoret»...

PRENKA — Kushedi, si kanë për të na pritur?

MARKU — Si kanë për të na pritur? O, more Prenk! Ne s'jemi krushq; s'jemi as bejlerë, as pashallarë... Ne jemi fukarenj; ne jemi të ikur e, të ikurit, s'priten as me flamur e as me borë...

GJONI — Besoj se nuk na vrasin, as nuk na rrjepin si këtu.

MARKU — Në fund të fundit, mjafton që ikim nga zullumi i turqve, nga vrasjet, nga luftrat, nga hajdutëritë, nga sëmundjet e hallet e gjithfarë lloji...

PRENKA — Mirë thua. Por, as që më shkoi ndër-mend se do na prisnin me flamuj e me violina, veç a mund të ndodhë mos na presin fare, dua të them, mos na marrin e na kthejnë mbrapsht nga kemi ardhur? Këtë mendova, kur ju pyeta se si mund të na prisnin.

GJONI — Mirë, Prenk, mirë. Domethënë se je kujtuar. Por duhet të dish se, punëtori, ku vete, mirë se vete. Së dyti, as ne s'i kemi kryet në thasë. Ata e dinë se do të vemi e na kanë lajmëruar se pranojnë.

MARKU — Më besoni, vëllezër, më duket se do ta kemi vështirë më shumë atëhere kur të kemi mbërritur. Se po ikim nga ky vend, ku shpesh herë bie murtaja, e ata kanë shumë frikë prej kësaj. Mund të mendojnë se po u çojmë murtajën.

GJONI — Pasha zotin, Mark, larg mendon, por s'bën të frikësosh veten dhe të tjerët me atë që «mund të jetë».

PRENKA — S'do të kishte dobi, po të flisja për këtë frikë me gra...

MARKU — Po, po. Këto janë biseda burrash e jo grash... Dhe tani, Prenk Vuka, do të mbe-tesh këtu? Duhet që gjithkush të gjendet te shtëpia e vet. — Po afrohet koha... Deri sa të shihemi! (*shkon*)

GJONI — Edhe për pak takohemi prapë. (*Shkon*)

PRENKA — (*pas tyre*) Mirupafshim! (*Futet në oborr*): Nita!

PAMJA E NJËMBËDHJETË

Nita e Prenka, pastaj Niku, Pali e Mimqi.

PRENKA — Nita!

NITA — (del në derë): Këtu jam, babë!

PRENKA — Si s'e ndeze një copë qiri? Pa shih se u shtri terri... Na duhet të shtjmë ndonjë kafshatë bukë para se të nisemi në... mje-gull. (Ngjitet në shtëpi. Pas pak duket pak dritë. Së largu dëgjohet një melodi e tri-shtuar)

NIKU

PALI

MIMQI

(këndoijnë jashtë skenës);

*Lamtumirë, o fusha t'mija
brigje, pyje, gjerdhe t'vjetër;
lamtumirë, o rrugt' e mia
unë më juve s'kam m'ju thirr',*

Lamtumirë!

(duke ardhur në skenë):

*Lamtumirë, o shpi e votër
derë, oborr, un' s'do t'ju shoh;
lamtumirë vllazën e motër.
Gjithmonë më keni qenë të mirë...*

(— duke dalë jashtë skenës)

*Lamtumirë, o vendl i dashur
me t'veshtira. zullum të keq:*

*lamtumirë, halle t'rënda,
mua m'duhet kësaj m'ju humb,
Lamtumirë!*

PAMJA E DYMBËDHJETË

Zefi vetëm

ZEFI — Tashti do të fillojnë të nisen. (*Ndihen gjelat e parë*) Të nisen? Jo të nisen, por të ikin, të ikin. Të braktisin tokën e shtëpinë ku kanë lindur, të lënë varfërinë e vet dhe të ikin. — Përse kjo jetë e zezë s'mund t'u jetonte në paqe në vendlindjen e vet? Pse guxon të jetë kështu? Përse këta të mëdhenjtë, këta me dorë të gjatë duan të na rrjepin edhe lëkurën nga trupi? Përse? Përse?

Edhe mua më duhej të ikja, të shpëtoja krenarinë e të isha me dashurinë time... O, sa vështirë e kam... Kushedi ç'po më pret nesër?.. Dhe, ti, Nita, Nita, po më shkon!.. A do të të shoh ndonjëherë?.. A do të mundem të të harroj? A do të mundem të duroj pa ty?.. Nita, Nita! (*Ulet pas murit*).

PAMJA E TREMËDHJETË

(Afrohet një burrë dhe një grua ngarkuar

me tesha në krah. Gruaja ka për dore një fëmijë pesë-gjashtëvjeçar. Në errësirë s'mund të njihen. Shkojnë «Bregut të zo-gjve»).

FËMIJA — Nënë, ku po shkojmë?

GRUAJA — Po shkojmë, biro, diku larg, ku kemi për të jetur më mirë se këtu.

FËMIJA — Për mua ka qenë mirë edhe këtu, nënë.

GRUAJA — Në do, bir, të të vrasin ushtarët, atë-here qëndro...

FËMIJA — E kur do të kthehem, nënë?

GRUAJA — Mos më pyet, biro...

BURRI — Mos folni! Heshtni! Nata i ka veshët të hollë... (*Shkojnë*). (Në anën tjetër duket një burrë *me tesha në shpinë*, një grua *me djep në shpinë*, e një vajzë *me një fëmijë katër-pesëvjeçar për dore*).

VAJZA — Shko, lëviz! Ç'po shtriqesh ashtu?

FËMIJA — Kam gjumë, nënë!

GRUAJA — Pastaj do të flesh, biro, pastaj.

BURRI — Bëhu trim, zogu i babës, bëhu trim!

FËMIJA — E pse po e lëmë shtëpinë tonë, babë?

BURRI — Po shkojmë të gjejmë një më të bukur, zogu i babës...

FËMIJA — E ku do ta gjejmë, babë?

BURRI — O, Zot, o Zot!

FËMIJA — A është Zoti i vrazhdë, babë.

GRUAJA — S'bën të flasësh natën. Hesht tani, hesht!
(shkojnë)

(Dëgjohet zëri i fëmijës: Kam gjumë, nënë).

PAMJA E KATËRMBËDHJETË

PRENKA — (*Del nga shtëpia me torbë në krah e me thes mbi shpinë, pas tij Nita me një thes më të vogël, shkon në oborr. Prenka ndalon pranë derës, ul thesin, ulet edhe ai në prag të saj... atëhere çohet dhe puth edhe derën e shtëpisë*): Lamtumirë, shtëpi e vogël e babës tim, shtëpia e ëmbël e nënës sime!.. (*Shkon rrëth oborrit e me dorë lëmon murin*): Lamtumirë, oborri im!.. (*E çon thesin në shpinë e niset.*)

ZEFI — (*U del përpara*): Prenk Vuka! Udhë e mbarë!.. Baba s'më erdhi... Mua më duhet të mbetem. Ju uroj gjithë të mirat!.. Shkoni me ndihmë të Zotit!..

PRENKA — (*me zë të dredhur*): Zef, bekimi im mbe-ttë me ty. Faleminderit për urimin e, lamtumirë!

ZEFI — Tungjatjeta, Prenk! — Të lutem: Më lejon të flas dy-tri fjalë me Nitën?

PRENKA — Folë, Zef, po shpejt.

NITA — Babë, vetëm një minutë.

PRENKA — Mirë, Nita, por flisni shkurt, se u bëmë vonë. (*Shkon*).

PAMJA E PESËMBËDHJETË

Nita e Zefi

ZEFI — (*Pas një heshtjeje të shkurtër*): Nita... Ti po shkon... Shko, Nita, shko! Shko, me zemrën time...

NITA — Zef, ti po qëndron... Me ty po mbetet edhe shpirti im, Zef!

ZEFI — Shko, Nita, shko... Unë vij pas teje, Nita... Vij, ose vdes!

NITA — Zef!.. Të pres, të pres!

ZEFI — Nita,jeta ime! (*E merr në gjoks dhe e puth*).

NITA — Faleminderit, Zef, për dashurinë tënde e përkëtë puthje të ëmbël që më dhurove...

ZEFI — (*nxjerr medaljonin*): Nita, mbaje! Është e së ndjerës nënë. (*Ja jep medaljonin*): Kujtomë.

NITA — Lehtë do ta kem të të pres, Zef, lehtë...

ZEFI — Tashti shko! Shko, Nita, se po më pëlcet zemra!

ZËRI I PRENKËS — Nita, lëviz pra!

NITA — (*Duke nxituar çon thesin*): Zef, të pres! (*del duke qarë*).

PAMJA E GJASHTËMBËDHJETË

ZEFI — (*Vetëm, duke shtrirë dorën pas Nitës*): Nita!... (*duke kapur kokën me duar*): Nita!... (*Mbas pak mylllet skena*).

AKTI II

*Tre vjet më vonë në Arbënesh. Funtana, uji buzë detit i mbuluar me kupolë me kolona, ngritur më 1546. Në mes të Funtanës uji i rrethuar me kurorë 80 cm të lartë. Në fund janë sigjet *) e gurta. Mbi sigje * rrasa e gurit me shkrim. Përpara Funtanës pritje për barka.*

Mendohet se këtu kanë zbankuar arbëreshët kur kanë mbërrijtjut në Zadër. E diel pasdite. — Ky akt ka një notë gjëzimi.

PAMJA E PARË

Prenka e Nita me një vedër në dorë

PRENKA — Në festë ka për të ardhur edhe guvernatori i arbëreshëve, zoti Kristofoli... Shumë jam dhënë e shumë jam lodhur pas kësaj pune, gjersa e kryejta. Më në fund na e pëlqyen dhe na e kanë pranuar kërkessën

*) Sigje: ndenjëse të gurta

tënde për t'u shpallur mashkull...*) Por ke akoma kohë të mendohesh për të dalë nga kjo baltë..

NITA — Jo, jo, babë. S'dua ta humbas këtë mundësi... (*mbështet vedrën në kurorë*)

PRENKA — Shiko, Nita, unë s'të thashë, se edhe pardje të ka kërkuar Mimqi i Gjonës... Djalë i pashëm, trim i bukur, punëtor i palodhur...

NITA — Ti, babë, s'më ke treguar, por unë e kam ditur vetë... (*lëshon kovën në ujë*)

PRENKA — Mendoje mirë edhe një herë, Nita, gjersa ke kohë. Nesër mund të jetë vonë e ka për të të ardhur keq!

NITA — Sa herë të kam thënë, babë, se zemra s'më ndjen asnje farë gjëzimi për martesë... Më mirë hidhem në det, se sa ta helmoj veten e burrin e ardhshëm... Mos më mërzit më, babë. (*nxjerr ujë*)

*) Fenomen shoqëror që është vënë re në Malësinë e Madhe, Mirditë, Dukagjin e gjetkë. Duket se ka lidhje me amazonet, gratë luftëtare të kohës së matriarkatit në sno-qërinë primitive.

Virgjinat, siç quhenin vajzat që shpalleshin mashkull përgjithësisht, për t'i shpëtuar një martese të padëshiruar, ose për të marrë gjak të hidhur, d.mth. kur ishin vrarë meshkujt e familjes a ndonjë vëlla i vetëm e s'kishte kush t'ua merrte gjakun, betoheshin para dymbëdhjetë pleqve të fisisit të tyre ose para kishës, se nuuk do të martoheshin, ndërronin emrin, duke marrë emër mashkulli, prisnin flokët, visheshin si burrat, rrinin me burrat, s'bënin punë grash, përgjithësisht mbanin armë dhe, shumë herë, merrnin pjesë aktive edhe në luftë.

PRENKA — E kam pér detyrë tē tē parashtroj pér tē fundit herë arësyet pér tē cilat s'duhet tē shpallesh mashkull. Së dyti, pleqtë kanë pér tē tē pyetur se pse s'pranon tē martohesh...

NITA — Në më pyetshin, do tē di t'u përgjigjem.

PRENKA — Nita, do tē tē bëj edhe një pyetje...

NITA — Pyetëm, babë.

PRENKA — Unë kam parë se ti, Nita, i do shumë fëmijët... Me ta luan, qesh, shëtit... me një fjalë, se fëmijët tē pëlqejnë.

NITA — Po, më pëlqejnë. (*Prapë nxjerr u jë me kovë*)

PRENKA — Pérse, atëhere, s'do tē më gëzosh, t'i sjellësh fatbardhësi shtëpisë tënde dhe vëtes fëmijë?

NITA — Pyetje tē vështirë më bëre, babë. Por, tē them tē vërtetën, më duket se...

PRENKA — Pse u ndale? Folë. Ti e di se unë jam edhe babë edhe nënë pér ty.

NITA — Në u bëftë, më duket babë, se... me këto duar kisha pér ta mbytur... e, para se ta shikoja...

PRENKA — O, mos e dhëntë zoti! Ç'po flet ti, Nita?

NITA — E, atëhere, e mbytja edhe veten...

PRENKA — Por, pérse? Pérse, Nita?

NITA — Sepse... sepse ky fëmijë s'do tē më delte nga zemra... (*gati duke qarë*): Fatkeqësi që kam... — (*Mbledh litarin dhe e vë në kovë*)

PRENKA — Unë s'po tē njoh dot ty, Nita! E egër je, e egër...

NITA — Mos më mundo më, babë. Ti më pyete dhe unë t'u përgjegja ashtu si ma ndjen zemra...

PRENKA — Atëherë s'mbetet gjë tjetër, veç tē shpallesh mashkull?

NITA — Ashtu, babë, ashtu. Le tē më lënë tē lirë

me dashurira e me të kérkuara... Le ta mbys zemrën — në lotët e mi...

PRENKA — Mirë, Nita, mirë. Por ta dish dhe ti, se me këtë ja këpüte zemrën dhe babës tënd.

NITA — (butë). Gjithë butësia e zemrës sime për ty është, babë. Me ty dhe për ty jetoj, sepse s'kam në këtë jetë kërkend përvëç teje!

PRENKA — (butë): O, Nita, Nita! Kushedi ç'fsheh në zemrën tënde?.. Kushedi si mund të mbarojë e gjithë kjo?.. Por, tashti, le të jetë si të jetë. Me mua je e me mua ke për të qenë... (E ndihmon të vëjë vedrën në kokë dhe ikin).

PAMJA E DYTE

Roza dhe Cana duke ardhur

ROZA — Këtu e kamë për të bërë festën? Vend të bukur kanë zgjedhur.

CANA — Unë s'mund ta marr me mend. Ndonjë farë dreqi do të jetë i përzier këtu... Parvjet e kérkoi Niiku i Dash Palit. Djalë më të mirë s'kishite. Vjet e kérkuau për Palin e Jakut, prapë djali si syri, si thuhet... Këtë vit dy herë e kérkoi Mimqi i Gjonës, djali si molla e kuqe... dhe ajo s'do asnjërin prej tyre. — E, këta djemtë tanë u qepën pas saj si të ishte djathë e mjaltë, sikur të mos ishte në jetë kurrikush tjetër, vec ajo vetë...

ROZA — Cana, mos është me të vërtetë mashkull?

CANA (*duke qeshur*): Ha, ha, ha! Ikë, moj e prapë, ti edhe ajo!

ROZA — E ç'po qesh aq shumë? S'mund të jetë?

CANA — E si të mos qesh, kur i ka të gjitha ato që e bëjnë femrën femër, ha, ha, ha!

ROZA — Thonë se ka nga ato që janë gjysmë femër e gjysmë mashkull... Mos është dhe ajo ashtu?

CANA — Më beso, Roza: ashtu si je ti dhe unë, ashtu është edhe Nita.

ROZA — Do të ketë... Vetëm më vjen çudi se përtë gjitha punët është e butë si dylli, ndërsa për djem është si hekuri.

CANA — Edhe unë për këtë po them, se s'po më shkon në mend... e këta tanët e rrethuan, si... sikur të mos kishte të tjera vajza, edhe të bucura, edhe të njoma, edhe të vyera...

ROZA — Hajde, hajde, nuk janë martuar të gjithë me Nitën. Edhe në u martoftë ndonjëri me të, mbeten të tjerë... mbetet edhe për ne ndonjë...

CANA — Mirë po thua. Sot e shpallin mashkull... kështu do të jetë përtë zgjedhur një më pak!... ha, ha, ha!

ROZA — Jam kureshtare përtë parë si kanë përtë shpallur mashkull... Kjo gjë ndodh shumë rrallë...

CANA — Dhe mua, Roza, gjithë kjo më duket sikurtë ishte një lojë...

ROZA — Hesht, mos folë. Mund të të dëgjojë ndokush, mund të ndërrojë mendimin e mos e bëjnë mashkull, atëhere djemtë nuk kthehen tjetërku.

CANA — Besa, Roza, kjo është e mirë! Ha, ha, ha!

ROZA — (duke qeshur): Dhe, nē ndodhtë që Nita,
kur tē bëhet mashkull, tē kërkojë ndonjérën
prej nesh pér grua, ç'bëhet?

CANA — Të tē marrë ty! Ha, ha, ha!

PAMJA E TRETE

NITA (duke u ngjitur): Mos u trembni, mikeshat e
mia, mos u trembni. Ju nuk ju gënjej, ndo-
një tjetër po! (Të tria qeshin).

CANA — Domethënë se na ke dëgjuar?

NITA — Keni folur me zë aq tē lartë, sa mund tē
dëgjoheshit gjer nē «Shönmark».

ROZA — A do tē tē bëjnë me tē vërtetë mashkull,
Nita?

NITA — Jo, Roza, nuk mund tē më bëjnë mashkull.

ROZA — Po si, atëhere? S'po marr vesh...

NITA — Tjetër gjë është tē bëhesh mashkull e tjetër
gjë tē shpallesh...

ROZA — Atëhere kanë pér tē shpallur se je mash-
kull?

NITA — Po, po. Do tē më shpallin...

CANA — Kurrë s'na e ke treguar shkakun, pse ven-
dose tē shpallesh mashkull...

NITA — Më duket se ju kam thënë shumë herë.
Nuk dua tē martohem.

ROZA — Po pse s'do tē martohesh? Apo s'je femër
si edhe ne?

CANA — Mos nuk tē pëlqeijnë meshkujt tanë?

NITA — Djemtë tanë janë tē mirë e tē pashëm, ja-
në trima e punëtorë... Po tē martohesha,

s'merrja kërkend, veç ndonjérin nga tanët.

ROZA — E ç'të pengon të marrësh një djalë për burrë?

NITA — Mëkeshat e mia, më dëgjoni: E merrnit ju drurin, gurin apo hekurin për burrë?

ROZA E CANA — C'po thua?

NITA — Desha të them se askush nga këta meshkuj s'më hyri në zemër e në shpirt, sikur të ishin dru, gur, apo hekur.

CANA — Meshkujt tanë s'janë pa ndjenja, pa zemër e pa gjak, Nita.

NITA — Jo, Cana, jo. Unë as po e them një gjë të tillë. Unë dua të them se zemra ime do të jetë pranë tyre si pranë gurit, hekurit, ose drurit. Domethënë se zemra ime është pa ndjenja, pa gjak,... se është gur, apo hekur...

CANA — Po prej se je ti, Nita? A s'je si ne, prej mishi e prej eshtrash?

ROZA — Ti, atëhere, s'ndjen dëshirë t'i afrohesh një djali?

NITA — Zemra ime është plot me dashuri të vdekur...

ROZA — Unë kam frikë prej teje, Nita!

NITA — (*duke qeshur*): Mos u tremb, Roza. Nuk të ha, as nuk të marr për grua.

CANA — A do të mbetesh mikesha jonë edhe kur të bëhesh mashkull?

NITA — Vajzave duhet t'u ruhem e mashkujve duhet t'u qëndroj larg. Dhe unë do të jem — mashkull! (*Të gjitha qeshin*)

PAMJA E KATERT

Të parët, Nita, Pali e Mimqi

NIKU (*duke mbajtur shkallët*): A po shikoni? Edhe vajzat kanë ardhur për të na ndihmuar...

PALI — (*duke mbajtur litarin të mbuluar me gjelbërimë*): Shiko, shiko! Kush kishte thënë se janë kaq të kujdeshshme?

MIMQI — (*duke i ndihmuar Palit, me flamuj pa shtiza*): O, o! Edhe Nita ka ardhur të shohë si po ja përgatisim festën.

ROZA — S'kemi ardhur për t'ju ndihmuar. U ndeshëm pa dashur.

CANA — Unë mendova se e keni mbaruar, e ju po qëndroni në vend. Dhe ju qenkeni vërtet dembelë...

NITA — Bukur më përgatisni, le të më jetë edhe festa e bukur.

NIKU — Më shumë do të më pëlqente, po të kisha zbuluar shtëpinë e saj për festë...

PALI — Unë do t'i kisha pranuar edhe duart, edhe flokët, po ta kisha prurë në shtëpi...

MIMQI — Folenë ta kam përgatitur në zemër dhe dera alkoma e hapur është...

ROZA — Cana, a po i dëgjon këta djem të pafytyrë? Sikur të ishte këtu vetëm njëra...

NITA — Ju faleminderit, o djem, për ndjenjat tuaja të holla...

CANA — A e di ç'më ra ndërmend, Roza?

PALI — Mos folë marrëzira, se i dëgjuam edhe ne.

ROZA — Çfarë, Cana?

CANA — Edhe unë shpallem — mashkull... (*Të gjithë qeshin*).

NIKU — Të lumtë, Cana, të lumtë!

MIMQI — Të lumtë, Cana! Atëhere na duhet të qajmë edhe pér ty, si pér Nitën!...

ROZA — E si qani pér Nitën?

PALI — (*duke hipur nē shkallë e duke vendosur kurorën*): Ne qajmë duke kënduar.

CANA — Duke kënduar? Si mund të qahet duke kënduar?

NIKU (*duke ndihmuar Palin*): Mundet, mundet edhe bulkur bile...

ROZA — Atëhere filloni, le të dëgjojmë.

MIMQI — (*fillon tē këndoje*):

*Pa ty nata s'më pëlqen.
Pa ty dielli s'më mxeh.
Buka pa ty nuk më shkon.
Dita pa ty kurr' s'mbaron.*

CANA — Besa, bulkur.

NIKU (*këndon*):

*Pa ty drita m'është me terr
se fort zemrën ma ke therr;
pa ty nata s'm'është me qejf,
sepse yjet s'dun me qeshë...*

ROZA — Kjo është edhe më e mirë!

CANA — Po ti, Pal?

PALI (*këndon*):

*Nata pa ty kurr' s'më del
sepse gjumi nuk më merr...
Pa ty koha s'më kalon,
sepse shpirti më ankon...*

CANA — Dëshiroja të më këndonit mua kështu.
ROZA — Edhe guri shkrihej e jo zemra që po e pol
MIMQI
NIKU
PALI } (këndojnë sëbashku):

Dritën, gjumin, bukën, pra,
vajz', o vajzë ma zrukuro!
Ma fal zemrën, m'i fal gjinjtë...
Unë ty jetën e të ritë!

NITA — Këngë e bukur. Fjalët e ëmbla dhe melodia
e bukur e prekin çdo zemër të gjallë, por
zemra ime është qyshkur e thyer, e vde-
kur. Nëse m'i drejtoni mua, ju falenderoj
nga zemra.

NIKU — Ty, ty, Nita, t'i drejtojmë.

PALI — Këto vjersha janë vetëm për ty, Nita.

MIMQI — Për ty i kënduam. Nita, për ty.

NITA — Edhe një herë ju falenderoj, vëllezër. Por,
për qetësinë e zemrës sime, drejtojuni të
tila fjalë të ëmbla këtyre vajzave, që janë
më të denja nga unë... Mirë mbetshi.
(Shkon).

PAMJA E PESTË

Të parët pa Nitën

PALI (*duke i ndërruar shkallët*): Nik, më ndihmo
edhe pak sa ta mbarojmë.

NIKU — (*duke ndihmuar*): Mbahu, mbahu. Jo në atë gozhdë, në tjetrën.

MIMQI — Sa flamuj qenë?

NIKU — Tre kanë qenë.

MIMQI — (*numëron*): Një, dy, po, tre.

PALI — Vajza, fshijini pak këto gjethë që kanë rënë përtokë.

CANA — Nu k ju ndihmojmë, se s'meritoni.

MIMQI — O, o! E pse, Cana?

CANA — Gjërsa qe Nita këtu, e nderuat, i kënduat... Tani që iku: «fshini ju vajza».

NIKU — Ha, ha, ha! Mbaje këtë, Pal!. Gjithë deti s'të lan dot...

ROZA — E pse qesh aq shumë? A s't'i ka mpirë edhe ty mendtë nj'ajo «me zemër të thyer e të vdekur»?

MIMQI — Pritni, vajza! Mos fluturoni si mizat në...

CANA — Ti je i detyruar të flasësh më pak nga të gjithë. Dy herë e ke kërkuar për grua, e të dyja herët të ka vënë — britë!

PALI — Ha, ha, ha! Edhe kjo është e bukur, apo jo, Nik?

ROZA — Shiko, zuri edhe ky të tallet tashti.

MIMQI — Por, pritni një çast, po ju them!

CANA — E ç'të presim, gjersa të shpallem mashkull?

NIKU — Besa, më duhet sa më shpejt të kap ndonjë vajzë, se mos i kap të gjitha marrëzia e bëhen meshkuj...

ROZA — Për inatin tënd do të bëhem edhe unë mashkull.

MIMQI — Ha, ha, ha! Pa shiko, Nik, c'po të përgatitet.

CANA — Ky do ta hegë veten tepër të urtë.

PALI — Vajza, si ju duket, t'i vendosim flamujtë më mirë kështu, apo kështu?

ROZA — S'është mirë nga kjo anë... ktheje në anën tjetër. Kush s'të njeh, shtrenjtë të paguante...

NIKU — Vërtet, koha po shkon e ne akoma s'jemi bërë gati.

CANA — Mund të punonit më shpejt, gjersa qe Nita këtu.

MIMQI — Qysh më parë desha të të thoshja, por me që e përmende vetë, po ta them tashti. Nuuk duhet të trembeni më nga Nita. Para se të shkonte tha: «Drejtojuni fjalë të ëmbëla këtyre që janë më të denja se unë...» A mund të fliste më bukur se kaq?...

ROZA — ...E me se ta fshimë këtë, kur s'kemi fshesë?

PALI — Ta kisha ditur se je aq e vlefshme, të kisha blerë...

CANA — Prapë fillova të na vësh në lojë. (*Mbledh gjethje*).

NIKU — Këtë e vendosim në mes, e këta të dy anash.

MIMQI — Pal, Nik! Shikoni që janë më të zonjat në punë se në llafe.

ROZA — Ajo që s'di të kuvendojë, s'di as të punojë.

PALI — Mimq, a rri mirë kështu flamuri?

CANA — Çoje palksa anën e djathjtë.

MIMQI — Po, po, çaje! Ashtu, ashtu.

NIKU — Tashti edhe këta të dy.

PALI — Shpejt, shpejt! Po ndihen zera.

ROZA — Ja, gati jemi.

MIMQI — Qilimin e shtrojmë në sigje, ë, si ju duket?

CANA — Në mes të sigjeve, ku kanë për të ndejnjur pleqtë. (*Ndihmon të shtrojnë qilimin*).

PALI — (*Fillon të këndoja, pas tij e marrin Niku e Mimqi*):

*Dritën, bukën, gjumin, pra,
vajz' o vajzë na zbuluro!
Ma fal zemrën, m'i fal gjinjtë.
Unë ty jetën dhe të ritë...*

PAMJA E GJASHTË

Të parët, gra, djem, vajza e fëmijë
(Ndërsa ata këndoja akoma, fillojnë të vinë)

ROZA — Për kë kënduat tashti?

NIKU — Kjo është për ty. Tashmë e shkula nga zerra rrahjen e fundit të dashurisë së vjetër dhe shikoj të ngul njerën të njomë, të re, që do të ma kënaqë zemrën...

NJË FËMIJË — Oh, nënë, sa bukur e kanë rregulluar!

PALI — (*I shpie shkallët jashtë. Kthehet*): Po mblidhen njerëzit, po mblidhen.

CANA — S'po duroj dot. Po pres të mbarojë sa më parë kjo komedi.

MIMQI — Pal, Nuk! Shikoni që janë më të zonjat në punë.

NJË VAJZË — E ku është Nita? Nuk po e shikoj.

ROZA (Palit) — A mund të mendosh, kush ta ngroh zemrën më shumë.

CANA (Mamqit) — Për të të folur ashtu haptazi, pa

kurrfarë rezerve, më ka ardhur shumë keq, se ju të tre keni humbur, jeni, si të thuash, jeni mbledhur pas saj, si të ishte e artë...

PALI (*Rozës*) — Tashti për tashti, as vetë s'e di me siguri. Më duhet të pres pak dhe të dëgjoj zemrën... Ajo që do të më thotë zemra, ajo ka për të qenë.

NJË GRUA — Shiko si e zbukuruan!

MIMQI (*Canës*) — Këto fjalë, Cana, nuk janë përkëtë vend, as për këtë çast. Pa shiko sa sy e sa veshë ka. Mund ta zgjasim këtë bisedë tjetër herë, po patëm dëshirë.

NJË DJALE — (*I afrohet Palit*) — Tungjatjeta, Pal! A do të fillojë shpejt?

PALI — Tungjatjeta! Mendoj se s'do të na duhet të presim shumë.

NJË NJERI (*Tjetrit*) — As kam parë ndonjëherë festë të tillë.

NJERIU I DYTË — Për zotin, as unë. (*Si mblidhet turma, fillojnë pëshpëritjet. Pa zhurmë, si në kishë, ndahen femrat nga meshkujt. Meshkujt në anë të majtë, femrat me fëmijë në anë të djathtë.*)

PAMJA E SHTATE

Të parët dhe, pas pak, pleqtë: Marku, Gjoni,
Jaku e Dashi

Pa bërë fjalë shkojnë në sigje e vendosen dy në një anë 'e dy në tjetrën. Mesin e lënë të zbrazët

Kur hipin, pëshpëritjet ndalojnë. Mbas pleqve një vajzë e vogël sjell një shportë me diçka brenda dhe, pasi e lë në kurorën e pusit, shkon edhe ajo në anën e femrave.

NJË FËMIJË — Ja tek janë, ja!

ZËRA — Kush, kush?

FËMIJA — Po vijnë, po vijnë!

ZËRA — Kush po vjen. Kush po vjen? (*Të gjithë përpiken të shkojnë. Pëshpëritje dhe zhurmë.*)

FËMIJA I — Prenk Vuka, po vjen Prenk Vuka!

FËMIJA II — Edhe Nita, dhe Nita është me të. (*E shkojnë si tallaz pas Prenkës*).

MARKU — E ç'keni sulmuar kështu si dhëntë në kripë!.. Shkoni në vendet tuaja. (*Turma tërhiqet*).

GJONI — (*pleqve*) — Si të ishin bagëti. (*Me zë të lartë*) Dëgjoni, apo jo? Shkoni mbrapa. (*Turma shkon mbrapa*).

JAKU — (*Një djali*) — Ti, si e ke emrin? Ti i Lek Pjetrit!..

NJË DJALË — Unë?

JAKU — Ti, po ti! Shko tek prifti në Shënmark. Thuaji të vijë se janë mbledhur të gjithë...

DJALI — Mirë. Shkova! (*Ikën*)

PAMJA E TETË

Të parët, Prenka e Nita

PRENKA — Mirë se ju gjej, o pleq e të rinj, bu-

rra e gra! (*Rri në rradhën e parë të burreave*).

PLEQTË — Mirë se vjen!

NITA — Nderimet e mia pleqve e të gjithëve!
(*Shkon edhe kjo në anën e femrave*)

PLEQTË — Me nder qofsh!

ZËRA — Mirë se vini! Shëndet! Nderime!

PRENKA — (*pleqve*) — Mos u mërzitët duke na pritur?

DASHI — Jo, Prenk... Tashti erdhëm edhe ne.

PRENKA — Pata frikë, mos u vonova...

MARKU — Jo Prenk, akoma s'kanë ardhur të gjithë.

PRENKA — I faleminderit mirësisë suaj.

GJONI — Si po ndjehesh ti, Nita?

NITA — Ju faleminderit, fort mirë jam.

NJË FËMIJË — Uh, kur do të fillojë?

JAKU — I kujt është ai budalla?

NJË ZË — I biri i Gjur Lekës.

MARKU — Mirë e kanë mësuar, mirë!

ZËRA — Vend, vend. Bëni vend. Erdhi prifti.

PAMJA E NËNTË

Të parët dhe prifti me një fëmijë me siq* për ujë

PRIFTI — (*Hyn me një libër të madh në dorë*)
Qoftë lëvduar Jezu Krishti. (*Shkon tek pleqtë; fëmija shkon pas priftit dhe e vendos siqin në kurorë të pusit*).

ZËRA — Në jetë të jetëve! Qoftë lëvduar! Gjithmonë!

* siq — enë për të nxjerrë ujë nga pusi.

PRIFTI (*pleqve*) — Më pritët shumë?

GJONI — Jo, jo, don Luk Toksha! Nuk do të ishte mirë të kishte ardhur zoti Kristofoli e të detyrohej të priste.

PRIFTI — Pra, s'ka ardhur akoma?

JAKU — E presim të vijë nga minuta në minutë..

DASHI — Ka vajtur ta thërresë Luk Kapetani.

PRIFTI — Mirë. Fort mirë. Po si jeni ju, pleq?

PLEQTË — Faleminderit, mirë! Mirë, don Luka! Faleminderit, uratë!

(*Të gjithë heshtën e çohen në këmbë*).

NJË ZË: Heshtni, heshtni, po vjen Luka — petani më një zotëri.

(*Të gjithë heshtin e çohen në këmbë*).

PAMJA E DHJETË

Të parët, Luk Kapetani e z. Kristofoli

LUKA (*duke hyrë*) — Mirë se ju gjejmë! Mirë se ju gjejmë!

ZËRA — Mirë se vjen, Luka-petani! Mirë se vjen!

KRISTOFOLI (*veshur alafranga*) — Tungjatjeta!

ZËRA — Tungjatjeta, zotni! Tungjatjeta! (*Të dy shkojnë te pleqtë*).

LUKA — A jeni, si jeni, burra?

PLEQTË — Mirë, mirë jemi. Ti si je? A je burrë?

KRISTOFOLI — Tungjatjeta!

PLEQTË (*me nderime*) — Tungjatjeta, zotni!

KRISTOFOLI — (*priftit*) — Salve reverendo! (*I shtrin dorën e flet me të diçka nën zë*).

PRIFTI — (*pasi foli me guvernatorin e me pleqtë*): Vëllezër e motra! (*Të gjithë dëgjojnë*): Në mëngjez ju thashë në meshë se sot, sipas ligjeve e zakoneve, do të proklamojmë mashkull Nitën e Prenk Vukës. Me kërkесë të Nitës, të cilën e ka pranuar si zoti guvernator Gjon Kristofoli, ashtu edhe pleqtë dhe kisha jonë e shenjtë, jemi mbledhur këtu, për të përfunduar para jush këtë proklamacion... Para se të fillojmë, na duhet të zgjidhim dy çeshtje: Së pari, na duhet të dimë drejtësisht në se e detyron ndokush Nitën të shpallet mashkull, domethënë, në se do vetë Nita, me vullnet, të shpallet mashkull dhe, së dyti, çfarë shkaku e shtyn të shpallet mashkull... Nita e Prenk Vukës, dil këtu para pleqve! (*Nita del përpara*).

MARKU — Na trego, Nita e Prenk Vukës, të detyron ndokush me forcë të shpallesh mashkull?

NITA — (*e turbulluar*) Jo, kurrikush s'po më detyron, as me forcë, as ndryshe.

GJONI — Nita e Prenk Vukës, a do ti, a dëshiron vetë?

NITA — (*me krenari*) Me qejfin dhe vullnetin tim dëshiroj të më shpallni mashkull.

JAKU — Nita e Prenk Vukës, ty të kanë kërkuar për grua disa djem... Përse nuk e zgjodhe ndonjerin prej tyre për shok?

NITA — (*me guxim*): Të gjithë djemptë që më kanë kërkuar... të gjithë janë të pashëm, të vyer

e trima. Shumë respekt kam për të gjithë, por zemra ime ka mbetur e thatë, e vdekur, kështu që, po të kisha marrë ndonjerin prej tyre për burrë, do ta kisha helmuar jetën time dhe të tij...

DASHI — Ti, Nita e Prenk Vukës, mund edhe të mos martohesh, të mbetesh vajzë... Ç'të shtyn të shpallesh mashkull?

NITA — Për qetësinë time, për qetësinë e djemve, ashtu edhe për qetësinë e vajzave, dëshiroj të shpallem mashkull.

LUKA — Unë s'kam menduar të të pyes asgjë, por këto fjalët e tua të fundit, nuk i kam të qarta. Të lutem m'i shpjego...

NITA — Për qetësinë time, dua të them: Le të rri në qetësi, mos më mërzisin më me të kërkua... Për qetësi të djemve mendova të them: mos mendojnë djemtë për mua, mos mendojnë: «Në mos ma pëlqen sot dashurinë, do të ma pëlqejë nesër»... Për qetësi të vajzave, desha të them se vajzat kanë të drejtë të zemërohen me mua, nga që s'e zgjedh njërin dhe të tjerët të mbeten të lirë... Kështu, duke pritur sa të zgjedh unë njërin — e unë s'mund të zgjedh — ato presin, e...

LUKA — Besa, fjalë të urta ke thënë...

PRIFTI — Nita e Prenk Vukës? E pse nuk bëhesh murgeshë?

NITA — Së pari... për t'u bërë motër murgeshë duhet një grusht asër... e, së dyti... unë kam dhe babën tim të dashur, i cili mbetet i ve-

t  m, pa k  rk  nd... Jo, jo! Un   s'mund t  l  .

PRENKA — (*me z   t     emb  l*): Nita, lulja e bab  s!...

MARKU — Mjaft, mjaft! Ti, pra, Nita e Prenk Vuk  s, mbetesh n   k  rkes  n p  r t  u shpallur mashkull?

NITA — (*duke marr   frys   thell  *) — Po... Ju lutem, m   shpallni... mashkull...

GJONI — (*priftit*) — Shko, vazhdo, urat  ...

PRIFTI — U b  ! Mbas k  saj prove, zoti Kristofoli, e pranoni ju proklamacionin?

KRISTOFOLI — (*pranon me kok  *) — Po, po!

PRIFTI — Ju pleqt   e katundit, e pranoni Nit  n e Prenk Vuk  s t   proklamohet mashkull?

PLEQT   — Po, po, po!

PRIFTI — At  here edhe kisha e shenjt  , sh  rb  tor i s   cil  s jam un  , e pranon Nit  n e Prenk Vuk  s t   proklamohet mashkull.

JAKU — Nita e Prenk Vuk  s,   far   emri ke zgjedhur?

NITA — (*e turbulluar*): Me d  shir  n tuaj, k  rkoj q   emrin t   ma ktheni nga Nita n   Ta-ni.

Z  RA — Tani! Tani! Tani!

DASHI — Nita deri sot, e qysh sot Tani i Prenk Vuk  s, a i ke dy kumbar  ?

NITA — Jo, nuk kam. (*Kthehet nga turma*) — Kush   sht   aq i mir  , p  r t   m   qen   d  shmitar?

Z  RA — Un  , un  , un  !

PRIFTI — Zgjidhi vet  , Nita.

NITA — (*duke menduar*) — Mimq i Gjonit, a ma b  n qejfin?

MIMQI — Edhe n   zjarr p  r ty, Nita...

PRIFTI — Edhe nj   fem  r...

NITA — Cana e Mark Ucit, a m   ndihmon?

CANA — Me qejf e me zem  r, Nita...

GJONI — (Nxjerr ujë prej pusit dhe i drejtohet priftit) Mbaroje pra, uratë.

PRIFTI — Me dëshirë të z. Kristofoli, guvernatorit të arbëreshëve, me dëshirë të pleqve të katundit e me dëshirë të kishës së shenjtë kato-like, ti, Nita e Prenk Vukës, qysh sot je (*e fut dorën në ujë dhe stërpik Nitën*) Tani i Prenk Vukës, në emër të atit, të birit e të shpirtit të shenjtë...

ZËRAT — Ashtu qoftë!... (*Pasi e kanë stërpikur me ujë, Kristofoli, pleqtë e dëshmitarët thonë: «Tani i Prenk Vukës», ndërsa turma, mbas tyre: «Tani, Tani». Gjersa këta e stërpikën, Nita qan, por turma s'e vë re*).

JAKU — (priftit) — Vure, uratë, këtë në libër, vure. (*Prifti hap librin dhe shkruan*).

MARKU — Tani, djali i Prenk Vukës, në shenjë të nderit tënd, merri nga unë këto tirqe... (*Nxjerr tirqet nga shporta*).

NITA — (*i merr tirqet*) — O, faleminderit!

ZËRA — O, ja fali tirqet! Tirqet ja fali!

GJONI — Tani i Prenk Vukës! Në këtë festën tënde, prano të marrësh nga unë këto opinga... (*Merr opingat nga shporta*).

NITA — (*duke marrë opingat*) Faleminderit!

ZËRA — Opingat! Opingat!

JAKU — Në kujtimin tim, o Tani i Prenk Vukës, merr nga unë kësulën. (*Nga shporta nxjerr dhe i jep Nitës një kapuç të bardhë*)

NITA — (*merr kapuçin*) — Ju falenderoj nga zemra!

ZËRA — Çula! Çula!

DASHI — O djale i ri, merre nga unë si kujtim këtë brez.

NITA — O, sa më keni gjëuar! Ju falenderoj nga zemra!

ZËRA — Edhe brezin! Edhe brezin! O! O!

KRISTOFOLI — (*heq koburen e nga letra lexon*) — Nita... Tani, Tani i Prenk Vulkës: Duke ndeuuar këtë festë, jam i gjëzuar se po mundem të të uroj emrin tënd të ri të mashkullit. Jam shumë i gjëzuar që mund të të fal këtë kobure të re. Mbaje me ndesi mashkull e si trim, në kujtim të ditës së sotme. Përdore vetë pér të ruajtur faqen e bardhë dhe nderin. (*I jep koburen dhe i shtrin dorën*)
— Tungjatjeta!

ZËRA — Koburja! Koburja e bukur! Koburja e re!

NITA — Zotni, s'kam fjalë, as di të flas bukur, por në zemër më mbetën fjalët tuaja! Faleminderit! Dhe 'koburen do ta mbroj si amanetin... (*Qan*)

ZËRA — Po qan! Po qan! Pse? Pér se? Ç'i ndodhi?

NITA — (*vjen në vete*) — Më falni! Zemrën e kam plot gjësim... aq plot, sa s'mund t'i mbaj të gjitha... (*duke qeshur*) Më duhet të derdh ndonjerën...

ZËRA — Ashtu pra! Jetë të gjatë! Rrofsh!

LUKA — Mirë, pra, por tani dëshirojmë të të shohim të veshur mashkull.

PLEQTE — Po, po! Shko e vishu si mashkull.

ZËRAT — Si mashkull! Si mashkull!

NITA — Cana, Roza, a më përcillni? A po më ndihmoni edhe sot?

CANA E ROZA — Po, po! (*E marrin pér dorë dhe me të dalin*).

PAMJA E NJËMBËDHJETË

Të parët, pa Canën, Rozën e Nitën.

MARKU — Prenk Vuka! Besa, ty të harruam në këtë festë të vajzës tënde. Mund të lavdë-rohesh me fëmijën tënd. E mençur është, zemërbardhë, e butë.

GJONI — Sa më shumë e dëgjoja, aq më e ëmbël më dukej. Të shikoni se si ajo s'kanë për t'u rritur të rinj...

PRIFTI — (*duke mbyllur librin*) U bë! U mbarua dhe kjo punë në emër të zotit... U mbyll libri!...

PRENKA — Dhe unë, baba i saj, nuk e kam shpirtin të qetë për këtë hap që bëri... Për ta thyer, s'munda, ose s'kam ditur. Tashti le të jetë në dorë të perëndisë... Prifti tha: U mbyll libri!...

ZËRAT — Tashti kemi një mashkull më shumë në katund... Por dhe një femër më pak!.. Në të vërtetë jemi sa kemi qenë!..

DASHI — Prenk, ti je me fat të bardhë! Një fëmijë ke, por e ke edhe djale edhe vajzë. Pak janë ata që mund të lëvdohen si ti...

PRIFTI — Të gjitha këto janë në dorë të zotit.

ZËRAT — A do ta njohim dot tashti që të vijë?... E, po të mos e dinim kush po vjen!... Po pres ta shoh sa më parë!...

JAKU — Të më kishte thënë ndokush se më duhej të isha gjykatës i tillë, s'do ta kisha zënë besë...

ZËRAT — Ja tek janë, ja tek janë! Po vijnë, po vijnë! Hapuni, hapuni! Prit të shikoj! O, sa i bukur duket diali i ri. Tani. (*Të gjithë janë të kënaqur, të gëzuar*).

PAMJA E DYMËDHJETË

Të parët, Nita si mashkull, me kobure pas brezit.

Cana e Roza

CANA — (*hipën e para, vajzave:*) — Deri tashti ka
qenë jona, e tashti...

ZËRAT — Tani, Tani! Djali i ri!

ROZA — (*Hipën pas Nitës, meshkujve:*) — Dhe tashti
është juaji!...

PLEQTË — Aferim! Aferim!

AKTI III

Tre muaj më vonë. Udhëkryq në bregdetin e veriut. Shihet rruga në të majtë e në të djathtë. Ndanë udhës murrriza. Shihen kopshte e ndonjë shtëpi e vogël. Në fund deti e atje larg një ishull i vogël, Shën Kelmendi. E diel pasdite.

PAMJA E PARË

Nita

NITA — (*e veshur si mashkull, duke parë diku larg*)... Tre muaj që jam veshur me këto rroba... se jam «mashkull»!... Mashkull!? Po,

mashkull për katundin, për njerëzinë, për djemtë e vajzat dhe për punë... Mirë, për punë. Le të jetë puna e mashkullit sado e rëndë, me vullnet e me dashuri e punoj, se pse tamam në punë e harroj veten dhe hahalin tim... Kur puna s'ma humbet mendjen, mendimi më shkon atëhere larg, atje larg, mbas detit e malesh, atje ku më ka mbetur zemra... atje... (*E nxjerr medaljonin, e puth e me zé tē émbël thotë*): Zef, o Zef, ku të kam? A të kam gjallë, Zef? A do të dëgjoj ndonjëherë ndonjë lajm përtty? Po të pres, Zef! Ndaj i kam veshur këto rroba që ma rrjepin lëkurën!... Pse s'mbeta atje ku je ti? O, jo, jo! Çfarë marrëzirash po flas? Po të kisha mbetur atje, do të bija në duar të tyre dhe kurkush s'do të më ndihmonte dot. Kështu, kështu zemra më ka alkoma shpresë... Kush e di? Të gjatë kanë qenë për mua këta tre vjet, por, duke pritur, më janë dukur të émbël... (*Prapë puth medaljonin*): Të pres, Zef, të pres edhe tre edhe tridhjetë e tre vjet! Të pres, gjer në vdekje të pres!.. Vetëm më vjen keq për rininë time dhe tënden, Zef. Sa më shumë kohë shkon që nga dita që u dashruam, aq më shumë më forcohet shpresa, se do të vish, Zef... A i dëgjon ti, Zef, lutjet dhe thirrjet e mia të përditshme? Mua më duket se i dëgjoj të tuat!... Eja, Zef, eja! Nita jote po të pret, siç pret lulja fluturën, si të ftohtët diellin!... (*E puth edhe një herë medaljonin, e fsheh në gjoks e si e gëzuar thotë*): Tani jam e kënaqur sikur të ishte

Zefi duke më dëgjuar, si të ishte këtu, di-ku afër meje!... O, ti, dielli im, nxehë një grimë edhe zemrën e Zefit tim! Nxehë, o dielli im, një grimë edhe dashurinë e tij përmua!... (*Shikon Rozën*).

PAMJA E DYTE

Nita e Roza

NITA — (thërrret) — Roza! Roza e Nik Lukës!
ROZA — (duke u afriuar) — O, o! A je ti, Tani? Mirë që u takuam! Qyshkur s'të kam parë.

NITA — As unë ty, Roza. Kam dëshirë të bisedoj pak me ty. Si më je? Diçka të re kemi dëgjuar për ty... a është e vërtetë?
ROZA — E ç'ke dëgjuar? Është e mirë, apo e keqe?
NITA — (duke qeshur): Mos u bëj budallaçkë, Roza, kur budallaçkë s'je.

ROZA — Më duket se kërkon të më vesh në lodër. Folë dlirë.

NITA — Roza, s'kam aspak ndërmend të bëj shaka me ty. Ty të kam si motër. Kjo e re që kam dëgjuar për ty, aq e madhe është sa... sa zemra s'mund të jetë e lidhur me asgjë tjetër, veç me të.

ROZA — (si e zemëruar): Nxirre, pra! Mos më mbaj përhunde!

NITA — Po shoh se duhet të bije në gjunjë përparrë teje e të të kërkoj falje. (Ulet në gjunjë): Më fal, pra! A do tjetër gjë?

ROZA — Po, po. Dua tē mē thuash ç'tē re ke dēgjuar pēr mua!

NITA — O, i mjeri unë!.. Dëgjova, pra, se po martohesh! Èshtë e vërtetë?

ROZA — Gënjeshtër, gënjeshtren ke dëgjuar, Tani! Akoma nuk po martohem. E vërtetë èshtë vetëm se mē ka kërkuar Pali i Jak Perajt...

NITA — Ashtu mē thuaj, ashtu! Këtë kam dashur tē di... Dhe, tē tutë e kanë pëlqyer djalin?

ROZA — Po. Tē mitë janë tē kënaqur.

NITA — Po ti, Roza! A je edhe ti e kënaqur?

ROZA — Po tē mos kisha qenë unë e kënaqur, as nuk do tē mē kishte kërkuar!...

NITA — O, sa mirë më vjen, më beso, Roza, e merri urimet e mia tē përzemërt! A jeni marrë vesh pēr ditën e martesës?

ROZA — (*si pa kujdes*) — Pēr tre muaj. Gjersa tē bëhemë gati edhe ne, edhe ata, në shtëpi tē tyre...

NITA — Nga zemra dëshiroj tē tē lulëzojë fati sot e gjer në brezin e katërt.

ROZA — Faleminderit, Tani, pēr urimin tënd tē bukur, por, në tē vërtetë, ke shkuan shumë larg. A ke dëgjuar ndonjë gjë pēr Canën?

NITA — Pēr Canën? Jo, asgjë s'kam dëgjuar.

ROZA — Mbrëmë edhe atë e kanë kërkuar.

NITA — Ç'po thua? Kush? Mimqi?

ROZA — Jo, jo, Niku i Dashit. (*Kalojnë dy fëmijë*).

NITA — Besa, bukur! Le t'u jetë me fat!... Shiko, shiko si u kapén dy diem tē mirë, tē bukur e tē vyer. Pali bilbil, Niku sokol! Shumë mirë! Le t'u jetë tē dyjave me bereqet!

ROZA — Më trego tashti, Tani, si po duken djemtë në lodra?

NITA — Si po duken? Të gjithë dinë... Pali yt éshtë i pari në këngë; Niku kërcen më shumë nga tē gjithë e Mimqi hedh gurë...

ROZA — Po ti, Tani?

NITA — (duke qeshur) — Unë? Unë jam më i mirë... në fjalë!

ROZA — A do tē marrësh pjesë sot në garën e vapimit?

NITA — Në vrapim kam për ta provuar edhe unë... (*Dëgjohet një klithmë fëmije*). Kush thërrret? Fëmijët! (*Vrapon në atë anë nga shkuan fëmijët*).

PAMJA E TRETE

Roza e, pas pak, Nita me fëmijën për qafe.

ROZA — (duke parë) — Ç'u ndodhi? Mos ra fëmija? Po! Ja, tek éshtë në ujë!... U mbyt?... Jo!... Ja, tek e kapi... (*Ndihen të qarat e fëmijës*). E shpëtoi!... I lumtë! Jetë tē gjatë, Tani!

NITA — (hipën me fëmijën e lagur tē përqafuar) Ai më i rrituri, kur pa se ky ra në det, iku... Mirë që u gjendëm këtu se, po tē mos kishim qenë, patjetër do tē qe mbytur... Do tē jetë i Ithës... Por, si tē bëj tashti?

ROZA — Çfarë?

NITA — Kam frikë se, po t'ja shpije fëmijën nënës, mund tē vonoj në vrapim...

ROZA — O, i shkreti fëmijë... E si ra në det?

NITA — As unë s'e di, si edhe ti! Bashkë qemë...

Kur u afrova, këtë e pashë në det dhe atë tjetrin tek po ikte... (*duke u lutur*): Atëhere, Roza, e shpije ti tek e ëma?

ROZA — Posi, Tani! E shpije, e shpije, mos ki frikë. (*E merr fëmijën që qanë duke thirrur: Nënë, nënë! Fëmijës*); Hesht, hesht! Tashti po shkojmë tek nëna... (*Nitës*): Unë po vete, por do të vij të të shikoj si do të vrapiosh.

NITA — Të shikosh si vrapijë unë, apo si vrapon Pali?

ROZA — (*duke ikur*): Dua t'ju shikoj edhe ty, edhe atë.

NITA (*pas saj*) — Shiko, shiko dhe shiko mos vonohesh!

PAMJA E KATËRT

NITA — Kanë zënë, pra, të martohen... Le t'i përcjellë fati ata, kur ma ka kthyer mua shpinë!... Bulkur janë zgjedhur: Roza e Pali, Cana e Niku. Bulkur! — Por, më vjen çudi se ç'po pret Mimqi... Këto ditët e fundit m'u dulk se ishte i sëmurë. Ose është dashuruar me ndonjëren, ose po mendon akoma pér mua... I shkreti ai... E mjera unë... Por, pér këto lloj sëmundjesh s'ka ilaç as pér të, as pér mua... (*Afrohen Pali e Niku*).

PALI (*Nikut*) — E shikon Tanin të vetëm?

NIKU — Si jo. (*thërret*): Tani, Tani!

NITA — O, ju të dy! Erdhët?

PALI — Erdhëm, erdhëm e të pamë si po rrije duke menduar me zë.

NITA — Tamam për ju të dy mendoja. Pak më parë vura re se keni vendosur e se i keni zgjedhur, mandej, vajzat...

NIKU — Kush të tregoi për mua?

NITA — Kush? Edhe zogjtë po pëshpërisin nëpër rrëmba e nëpër gjerdhe...

PALI — Na duhet edhe neve që dikur të formojmë familjen tonë. U plakëm duke pritur...

NIKU — ...dhe duke kërkuar vajzën...

NITA — Ju qoftë me fat të bardhë e plot me bëreget! Por më intereson edhe se ç'bëhet me Mimqin. A e ka gjetur edhe ai vajzën e vet?

PALI — Mimqi po thua? Mimqi? Mimqi është i... përvëluar...

NIKU — ...e i përcëlluar.

NITA — C'po thoni?

PALI — Kush përvëlohet shumë një herë, ai ruhet edhe nga ujët e vakët... Ashtu, bije fjala...

NITA — Nuk po marr vesh...

NIKU — Mimqi, duke fluturuar shumë rrëth «një kandili», i përcëllloi krahët më shumë se me dy, kështu që i duhet të pushojë më shumë se ne të dy... E more vesh?

PALI — (këndon me zë të ulët):

*Një ditë tata birin pyet:
Pse, beqar ti don me mbet?
T'duhet vajzën me kërku,
në shpi nusen me ma pru!*

Niku — (vazhdon pas tij):

*Nëna birin k'shtu e prit:
Dua nipat me t'i rrítë;
m'u martue mos vono,
lezet nanës mos ndalo!*

PAMJA E PESTË

Ata dhe Mimqi, pastaj burra, gra, vajza, fëmijë

MIMQI — (duke u afruar, pasi mbaroi Niku, e vazhdon këngën):

*Biri prindve at'her' u thotë:
Zemra ime ësht' e thatë;
lulja e zemrës nuk më do:
Pa 'dashni martesë s'ka!*

NIKU — Të lumtë, Mimq, të lumtë!

PALI — Besa, bukur!

NITA — Tungjatjeta, Mimq! Bukur e këndove! Tamam si duhet!

MIMQI — E këndova ashtu si ma thotë zemra. (*Nitetës*): Po ti? Si dukesh? A t'u bë zakon të vishesh e të sillesh si mashkull?

NITA — Çdo çudi duron tri ditë... Ashtu dhe kjo imja. Të them të vërtetë, ditët e para s'e pata lehtë. Por tashti jam mësuar. Tashti, me këto rroba, më duket më lehtë e më bukur se sa me ato të femrës.

NIKU — Të dielën e kaluar nuk deshe të merrje

pjesë në hedhjen e gurit. A ke për të vra-puar sot me ne?

NITA — Po. Edhe në mbetsha pas gjysmë udhe, sot do të marr pjesë në vrapim. Por, kini kujdes! Unë kam vrapuar mirë edhe me rroba femrash...

PALI — Shiko, shiko! Po na vë në garë! Këtë na duhet ta mbajmë mend! E, Nik, ç'po thua ti?

NIKU — Për besë, në mundsha, nuk i ndërroj petkat e hershme...

NITA — Dhe unë po ju them, se të tillë nder as nuk pres, as nuk pranoj! Barabar me ju, me të gjitha kushtet. Ndryshe...

MIMQI — Po, për besë, ato janë fjalë trimi. Katundi po flet edhe për trimërinë tënde të sotme...

NIKU — Për trimërinë e sotme?...

PALI — Të Tanit?

MIMQI — Po, të sotmen, të Tanit. Çfarë, ju s'dini gjë? Nuk jua tregoi Tani?

NIKU E PALI — (bashkë) — Jo, jo! S'na tregoi asgjë.

MIMQI — Atëhere, le t'ju tregojë vetë Tani. Si t'ju tregoj unë, kur ai është vetë këtu. Ai, pra, e di më mirë e më bukur se unë.

NITA — Të lutem, Mimq, mos u bën budalla! Çfarë marrëzirash po flet katundi për mua? Trego!

NIKU E PALI — (bashkë): Trego, Mimq, trego!

MIMQI — Atëhere, mirë: pak më parë Roza pruri fëmijën e Ithës krejt të lagur...

NITA — O, atë! Besa, gati sa s'më ra zemra në thembër, duke menduar se kushedi ç'qe...

PALI — ...Po thua se Roza e pruri fëmijën e Ithës në katund...?

MIMQI — Tashti mund tē vazhdojë vetë Tani.

DY NJEREZ — (*duke u afruar*) — A po bisedoni...
(Shkojnë në një anë e bisedojnë me zë të ulët)

NIKU — (*U përgjigjet*) — Po, ka pak.

PALI — Trego, Tani, trego!...

NITA — S'kam c'të tregoj. Këtu, para se tē vinit ju tē dy, bisedonim unë e Roza...

PALI — ...Si s'më the se ka qenë... ?

NITA — ...S'të thashë? S'të thashë, se s'më pyete!
S'kam ditur more, se Roza...

PALI — (*ja pret fjalën*) — ...Mirë, mirë. Vazhdo pra,
se po presim.

DY GRA — (*duke u afruar*) — A po rrini? (*Shkojnë mënjanë*)

NIKU — Po bisedojmë...

NITA — Ashtu, duke biseduar, dëgjuam një zë tē dëshpëruar fëmije... Vrapova dhe e pasë fëmijén në det; e nxora dhe ju luta Rozës që t'ja shpinte nënës, se kisha frikë mos vonohesha në garë... Kjo është e gjitha...

NJË FËMIJË — (*tjetrit duke ardhur*) — Ja, ky është Tani që shpëtoi... (*dalin*)

MIMQI — Po e shikoni edhe vetë që Tani s'është mburracak. Edhe punën e madhe ai e zvogëlon aq shumë si tē ishte asgjë...

NIKU — Të lumtë! Ashtu duhet, kur je dhe vetë i përzier në punë...

DISA VAJZA (*duke biseduar e duke qeshur*) — Mirëdita! (*Shkojnë e vendosen në skenë. Flasin me njëra-tjetërën me zë të ulët*)

PALI — (*duke u përgjegjur*): Mirëdita, vajza! Erdhët për të parë vrapimin?

NJË VAJZË — Erdhëm t'ju shikojmë ju.

PAMJA E GJASHTË

Të parët dhe pleqtë Mark Uci, Dash Fali,
Jak Peraj e Gjoni i Skënderit

MARK UCI — A jeni, si jeni, trima?

DASH PALI — Tungjatjeta, burra!

JAK PERAJ — Mirëdita, të rinj!

GJONI I SKËNDERIT — A po bisedoni?

MIMQI — Ju faleminderit, mirë jemi!

PALI — Tungjatjeta, pleq!

NIKU — Të mirë paçi, ju, gjyqtarë!

NITA — Shëndet paçi!

MARIKU — Le t'ju them dy fjalë, o djem. Neve, pleqve, na kënaqet zemra, duke ju parë që e punoni me qejf tokën tonë të re, me shatë, me capu¹⁾, me furqe e me drapër; me djersë në ballë e me kallo në duar, përtë nxjerrë prej gjirit të saj ushqimin përvete e përfamiljen tuaj. Por edhe më shumë na gëzohet shpirti duke ju parë në ditë festë, kur merrni pjesë në lojnat bujare, përtë forcuar muskujt e vullnetin tuaj, duke gëzuar, njëkohësisht, edhe prindërit e përtë dhënë një shembell të bukur përmë të rintjtë! Aferim!

DASHI — Mirë thua, Mark. Por, shumë e bukur është kur të rintjtë tanë na thérresin edhe neve, pleqve, në këto lodrat e tyre, jo vetëm si spektatorë, por edhe si — gjyqtarë... Ju lumtë!

1) kazmë

JAKU — Lavdërimi juaj, o pleq, është me vend dhe unë bashkohem me mendimin tuaj, por lavdërimi është më i mirë kur nuk tepërohet. Veprat flasin vetë... A shkojmë të fillojmö vrapiimin?

GJONI — Po, po! Por, në rradhë të parë, të caktojmë pjesëmarrësit. Kush pra, do të marrë pjesë në vrapim, le të dalë këtu, para nesh. (*Dalin Mimqi, Niku, Nita dhe dy djem*)

DASHI — Mimqi i Gjonës, Niku i Dashit, Pali i Jakut, Tani i Prengës, Gjoni i Lekës dhe Zefi i Markut... Kush tjetër?.. Kurrkush?... Mirë.

JAKU — Dëgjoni nga duhet të vraponi: Udhë e Nermjedun, rruga e Parë, gjer në Shënmark, pastaj udhës së Macaranit e deri këtu. Në kthesa të udhëve kemi vendosur nga dy dëshmitarë, për të qenë të gjithë në tregull. — Kush nuk do të shihet në këto kthesa, del jashtë garës... Asnjë farë justifikimi nuk do të ketë...

DASHI — Zini vendet: tre nga tre, se udha është e ngushtë. Mimqi, Niku e Pali të parët, dy hapa pas tyre, Tani, Gjoni e Zefi. Rreshtit të dytë, në u dashtë, ja njohim këto dy hapa.

GJONI — Djem trima, ju jeni të drejtë, nuk i bëni njëri-tjetrit hile. Këto i themi se duhen thënë, se gjëra të tilla nuk ndodhin te ne.

MARKU — A i keni marrë vesh kushtet?

VRAPUESIT — Po! Po! Po!

MARKU — Tashti vini re! Unë kam për të numëruar: një, dy e, në vend që të them tre, keni për të dëgjuar krismën e kobures. (*E heq koburen dhe e bën gati*): Gati! (*e çon koburen lart*)! Një! Dy! (*Krisma. Me të dë-*

*gjuar koburen tē gjithë vrapojnë, vetëm Ni-
ta mbetet një çast, pastaj edhe ajo vrapon.
Ndihen tē qeshura. Tē gjithë i ndjekin me
sy vrapuesit...)*

PAMJA E SHTATE

**Të parët pa vrapuesit, Cana e Roza vijnë
duke nxituar**

CANA — Janë nisur? Janë nisur?

ROZA — Oh, jemi vonuar!

NITI VAIJTI — Tashti sa u nisën, si plumb pushke!...

NITI FËMLIË — Vetëm Tani vonoi paksa!

CANA — Uh, sa më vien keq që nuk i pashë!...

ROZA — Të thashë që do tē vonoheshim, po ti s'de-
she tē më besoje.

CANA — (e zemëruar) — Mos më zemëro edhe më
shumë se ç'jam!

ROZA — E pse zemërohesh tashti me mua? Unë s'të
kam faj.

CANA — Hesht! Dhe më le tē qetë, tē them. S'shi-
kon që jam e zemëruar si bisha! Uh!...

MARKU — Edhe ju doni tē kapeni përflokkesh, këtu
përpara nesh... Si s'keni aspak turp?...

DASHI — Së pari: Kush vonon, s'shikon. Së dyti:
Fajin s'jua ka njeri, e keni vetë. Së treti: E
shikoni dhe vetë që një gabim sjell pas edhe
tjetrin!...

ROZA — Mua më vjen keq se jam vonuar, por s'jam e zemëruar me asnjeri!

CANA — Edhe unë më shumë dua ta derdh hidhërimin, se ta mbaj në zemër!...

PAMJA E TETË

Të parët e Luk Kapetani

LUKA — (*duke u afruar*) Tungjatjeta! Mirë se ju gjeta!

ZERA — Tungjatjeta, Luka-petani¹⁾. (*Cana e Roza akoma grinden*)

LUKA — Njerëz, më dëgjoni! Kam për t'ju treguar një lajm të ri...

MARKU — Luk, është i mirë, apo i keq?

LUKA — I keq nuk është. Mund të thunet se është i mirë...

JAKU — Nxirre, thuaje! Mos na bën të presim.

LUKA — As kam menduar t'ju ndez kurreshjen. Dëgjoni, pra. Sot jam takuar me një arbëresh të ri.

DASHI — Me një arbëresh të ri?

LUKA — Me një arbëresh që ka ardhur nga anët tona...

JAKU — ...Që ka ardhur nga anët tona...

1) Luk Kapetani, Lu-kapetani, Luka-petani, Luka Pe-tani kështu erdhi dhe emri i fisit Petani në Arbëresh.

LUKA — Po, ka ardhur nga Brisku dhe sot do të vijë tek ne...

MARKU — Folë, pra! Mos na kryqëzo!

ZERA — Kush është, kush?

LUKA — Jo, këtë s'jua tregoj! Dua të shikoj, a keni pér ta njohur?

CANA — Është i ri?

LUKA — I ri është, i ri dhe i bukur si lulja...

ROZA — A ka ardhur ndokush tjetër me të?

LUKA — Vetëm është. Kërkend s'ka me vete...

CANA — (me vete) — Kush do të jetë?

ROZA — Prej ç'katundi është?

LUKA — E thashë një herë. Prej katundit tonë të vjetër. Prej Briskut.

CANA — Unë s'po mund të sjell asnje ndërmend...

ROZA — As unë s'po kujtohem...

LUKA — Dhe unë po ju them: edhe kur ta shikoni, do t'ju duhet të mendoni gjatë pér ta kujtuar...

JAKU — Dhe po thua, se do të vijë këtu? Kur?

LUKA — Nga çasti në çast mund të vijë.

DASHI — A është i afërt me ndonjë prej nesh?

LUKA — Atë do ta mësoni kur ta shikoni.

ROZA (Canës) — Cana, si të duket ty, kush mund të jetë?

CANA (Rozës) — E ç'dreqin po më pyet mua? Kokën e kam të zbrazët si kungulli. Pyet Lukapetanin...

PAMJA E NËNTË

Të parët, dy dëshmitarë dhe Itha (Vijnë dy dëshmitarë duke nxituar)

NJË DËSHMITAR — Gjashtë prej tyre e kaluan rregullisht kthesën e rrugës.

MARKU — Mirë. Ata gjashtë qenë.

ITHA — (*vjen shpejt, kërkon dikë ndërmjet tyre*)... Çfarë, nuk është këtu?...

ROZA — Jo, Itha, nuk është. As ka ardhur akoma...

ITHA — (*Rozës*) — Kush s'ka ardhur?

CANA — Ç'po kërkon, Itha?

ITHA — (*Canës*) — Atë që ti nuk e ke humbur...

ROZA — Po të them, se as ka ardhur akoma.

ITHA — (*Rozës*) — Shiko, kjo! A ka për të ardhur nga... nga Brisku?

ROZA — E, nga Brisku!

ITHA (*shikon Rozën*) — Mos po të vjen mendja vërdallë ty, vajzë?

CANA (*Ithës*) — Ti je Itha — si hithra! Mirë të tha: nga Brisku.

ITHA — (*tani shikon Canën*) — A keni ngrënë ju groshël, ju që po ju vinë mendtë vërdallë? Kanë kaluar tre vjet që kemi ardhur nga Brisku dhe tashti këto: ka për të ardhur...

ROZA — E, ti, Itha, ngul këmbë në tënden.

CANA — Ti, Itha, atëhere, do të thuash se gënjen Luka-petani?

ITHA — (*bën kryq*) — Në emër të atit... çfarë dreqi ju ka mpirë mendtë?

DASHI — Itha është e rrezikshme sot...

ITHA — O, po të mund t'ju digjja si me hithër, do

t'ju përcëlloja aq; sa tetë ditë të mos dilnit dot nga shtëpia. (*Fort e zemëruar*): Ç'dreqin jeni kapur sot kështu me mua!?

LUKA — Na thuaj, Itha, kë po kërkon?

ITHA — (*pak e zbutur*): Luka-petani, para gjysmë ore Tani i Prenkës më shpëtoi fëmijën nga vdekja. Më thanë se e gjej këtu. Doja t'i puthja dorën e bekuar... E këto të dyja janë kapur me mua e duan të më bëjnë budallaçkë. Një ditë kam për t'jua prerë gjuhën e gjatë që kanë...

LUKA — Faljua këtë herë, Itha. Tani do të sqarohet. (*E shikon Zefin dhe hiqet mënjanë*)

PAMJA E DHJETË

Të parët dhe Zefi i Ucit.

ZËRA — Tek është, po vjen një zotni, neshtni, heshtni!

ZEFI — (*veshur alafranga*). (*Nga larg*): Dobar dan!

GJONI — Dobar dan.

ZEFI — (*kur afrohet, shikon nga grupi dhe thotë*): Shqiptarë jeni ju?

ZËRA — Arbërisht po flet, arbërisht!?

GJONI — Po, shqiptarë jemi.

ZEFI — (*i gëzuar*) — O, më në fund ju gjeta! (*I shikon në fytyrë*) O, pasha zotin, ky është Marku i Ucit! A je burrë, Mark?

MARKU — Po, burrë jam, faleminderit zotërisë suaj. (*Pleqtë afrohen ngadalë*).

ZEFI — Për zotin, ky është Dash Pali!.. Dhe ky,
Jak Peraj!.. A jeni shëndoshë? Si jeni?
(*U shtrin dorën*)

DASHI — Ju faleminderit, mirë jam.

JAKU — Ashtu, si do zoti.

ITHA — (*mënjanë*) Ky zë... ky zë...

ZEFI — (*E shikon Ithën*) — Dhe ti je Itha, e shoqja
e Gjon Skënderit! Dhe ky është Gjoni i
Skënderit (*i shtrin dorën*). Si je, Gjon?

GJONI — Mirë jam, faleminderit.

ITHA — (*duke menduar*) Ky zë... Prit, prit...

ZEFI — ...S'po më njihni?

ITHA — Ti je... prit, ti je... Zefi!.. Zefi i Ucit!

ZEFI — Po! Unë jam Zefi... Zefi i Ucit. po!

ZËRAT (*me çudi*): Zefi!.. Zefi i Ucit... Zefi i Ucit?
Kush kishte thënë? Kush e kishte njobur?...

MARKU — Zef! Zef i Ucit?.. Ma jep dorën edhe një
herë, Zef! A je, si je, Zef!

ZEFI — Faleminderit, mirë jam!

DASHI — Zef? Më fal, që të prita ashtu pa zemër,
më fal! A je burrë, Zef?

ZEFI — Të faleminderit për këto fjalë nga zemra...

JAKU — Shumë ke ndryshuar Zef! Dhe këto rroba
të kanë ndryshuar edhe më shumë. Ndaj
s'të njobëm. Na fal, Zef, na fal!

ZEFI — S'kam ç'tju fal. Zemra ime është plot me
gëzim që po ju shoh gjallë e shëndoshë.
(*E rrrethojnë të gëzuar*)

ITHA — Megjithëse është veshur me këto rroba,
unë e njoha, unë e njoha!

MARKU — E kur erdhe, Zef?

ZEFI — Këtu në Zadër erdha dje.

DASHI — E pse s'erdhe tek ne menjëherë?

ZEFI — Megjithëse jeni afër qytetit, është shumë

vështirë t'ju gjesh. Askush nuk di gjë për emrin Shqiptar... ose, në e di s'do të tregojë.

GJONI — Po, Zef, po. Ashtu është. Nuk dinë për emrin shqiptar. Këtu na thërresin arbanasi, ose albanezi, por edhe ne i thërresim vetes arbëresh.

ZEFI — Kështu do t'ju kisha kërkuar edhe një javë... Për fat të mirë takova Lukën... Po si, nuk është Luka me ju?

LUKA — (*afrohet duke qeshur*) — Këtu jam, Zef, këtu.

ZEFI — Shikoni, vëllezër, ai, Luka më pruri tek ju...

JAKU — Kur je nisur nga krahina, nga Brisku?

ZEFI — Qyshkur. Kjo është dita e pesëmbëdhjetë që jam në rrugë...

LUKA — Edhe ne e kemi pasur shumë të vështirë gjersa u vendosëm këtu...

ZEFI — E ç'do të thuash, pse ju kanë vendosur tamam këtu?

LUKA — Vëllai im, le ta them shkurt. Ky qytet ka mbetur pa rrethina të tij, pa jetë, pa punëtorë... Qytetit i duhen duar të shëndosha për të punuar tokën; për t'u prurë ushqimin gjahtarëve...

ZEFI — E si jeni? Si ja kaloni këtu?

MARKU — Qdo vit e më mirë. Kemi shpresë se edhe për ndonjë vit e mund të ecim me këmbët tonë...

JAKU — Dhe këtujeta është e rëndë dhe e vështirë, por nuk mund të barazohet me krahinën.¹⁾ Këtu merret frysë shumë më lehtë se atje...

1) Këtu — Briskun

GJONI — E si është tashti në vendet tona të vjetra?

ZEFI — Si është sot, nuk di. Por, kur isha atje, akoma qe tamam siç ka qenë kur ishit edhe ju, në mos edhe më keq!... Mendoj se mund të prisni ndonjë grup prej tanëve... vetëm në mundshin të ikin...

PAMJA E NJËMBËDHJETË

Të parët dhe Prenk Vuka

PRENKA — (*afrohet*) — E ç'jeni grumbulluar ashtu?
(*grumbulli ndahet pak*)

ZEFI — (*e shikon Prenkën*) Prenk Vuka! O Prenk Vuka! (*Shkon tek ai dhe e puth*): O baba im i dytë! A më je gjallë, Prenk?

PRENKA — (*i çuditur*) — Po, po, gjallë jam dhe po shoh se edhe ti gjallë je...

ZEFI — ...As ti, Prenk Vuka, s'po më njeh?

PRENKA — Po shoh, more, se je yni, por...

ZEFI — Unë, unë jam... Zefi i Ucit!...

PRENKA — (*i çuditur*) — Po, po, gjallë jam dhe po shoh se edhe ti gjallë je edhe një herë në krahët e mi!... Zefi i Ucit? Si më je, biro?...

ZEFI — Tashti, Prenk, mirë. Tashti mirë... E ti, Prenk, si je ti? Si janë të tutë?...

PRENKA — Gjallë jemi... Shëndoshë jemi... E ti, Zef?... Baba...

ZEFI — Mos më pyet më, Prenk!... Tjetër herë... Për mua sot dita është aq e bukur, aq e ëmbël... Mëkat do të ishte ta prishja...

ZËRA — (*ndihen nga larg*): Mbahu, mbahu edhe pak! Ikë, ikë, po të afrohet!
NJË FËMIJË — Po vijnë, po vijnë!
MARKU — Hapuni, hapuni! Bëni vend!
ZËRA — Tek éshtë! Tek éshtë i pari! — Kush éshtë? Kush éshtë?
ROZA — Tani! Tani éshtë i pari! (*Bërtet*): Mbahu, Tani, mbahu!
CANA — Vrap, vrap! I pari je, i pari!

PAMJA E DYMËDHJETË

Të parët, Nita, pas saj Mimqi, mandej Niku, Pali e të tjerë.

NITA — (*hipën duke vrapuar, merr frymë thellë e shpejt*).
ZËRA — Të lumtë, të lumtë! I pari, i pari!
ITHA — Të lumtë, të lumtë, zogu i tatës!
ZËRA — Ja dhe i dyti! I dyti! Kush éshtë, kush?
NJË FËMIJË — Mimqi, Mimqi i Gjonës!
ZËRA — Të lumtë, të lumtë, Mimq!
MIMQI — (*hipën edhe ky duke vrapuar e duke marrë frymë shpejt e thellë*). Të lumtë Tani! Fluturove pranë meje si plumbi. Të lumtë!
NITA — Nuk ma merr për keq, Mimq?
MIMQI — Besa, Tani, trim je! Faqja e bardhë më të mirit!
ZËRA — Të tjerët!... Dy janë bashkë...
ROZA — Vrap, Pal, vrap!
CANA — Mbahu, Nik mbahu! (*Të dy bashkë hipin të djersitur duke marrë frymë shpejt*. Pali

shkon tek Roza e Niku tek Cana. Këto u fshijnë djersët).

NITA — (Mimqit): Gjithmonë ke qenë trim dhe burrë!

ZËRA — Tek janë të tjerët! (Duke vrapuar vijnë dy dëshmitarë. Dicka flasin me Mark Ucin).

MARKU — Sipas vërtetimit të dëshmitarëve, fitues i vrapimit të sotëm shpallet Tani i...

NJË ZË — Tanit të Prenkës! Urra!

ZËRA — Urra! Urra! Urra!

ITHA — (i afrohet Nitës): E ku më je krenaria e arbëreshëve... Lemë të të puth dorën e bekuar... (Do ta marrë për dore).

NITA — (e tërheq dorën): Jo, jo Itha! Të ta puth unë ty. (E puth në ballë)

ITHA — E bekuar qofsh, kudo që të jesh!..

LUKA — (afrohet) Merr urimin tim nga zemra! Një-rën dorë ja shtrin Nitës e tjetrën ja shtie në krah) Na trego Tani, si ndodhi që i kalohe gjithë vrapuesit?

NITA — Nu kë di as vetë... Gati gjysmën e udhës kam qenë i fundit... Atëhere dicka më tha në zemër: «Ky vrapim është kobi yt!» As vetë s'e di si i kapa... e si i kalova.

MARKU — Sido që të jetë, fitorja jote është e drejtë. Të uroj nga zemra!

DASHI — Aferim, djale i ri! Nëma dorën e trimit!...

JAKU — Zbardhe faqen tënde dhe të babës!..

GJONI — Nderim më të mirit! Aferim, djalo! (Të gjithë e urojnë për fitoren. Dikush i shtrin dorën, dikush i bie lehtë në supe, dikush kështu, dikush ashtu. I fundit afrohet Zefi).

ZEFI — Djalë i panjohur, më fal. le të të uroj dhe unë... (E shikon me sy): Ni-Ni-ta!...

NITA — (*duke vërejtur Zefin, e habitur*): ...Zef!...
(*dhe bije pa ndjenja në duar të Prenkës. Të gjithë mbeten të habitur*).

ITHA — (*duke i shtënë dorën si për t'u lutur*) ...Yjet kanë parë...

AKTI IV

Tre muaj më pas. Funtana si në aktin e dytë,
por jo e zbukuruar. Është e diel pasdite.

PAMJA E PARE

Mark Uci, Gjoni i Skënderit, Dashi i Palit, Jak Peraj si gjykues, me ta: prifti e Luk Kapetani, Prenk Vuka, Mimqi, Pali, Niku, Itha, Roza, Cana; djem, gra e vajza. Anash gjykuesve është prifti e Luk Kapetani.

PRENKA — (*përpara gjykuesve*)... Pasi e çova të ndjerën në varr, më mbeti vajza katër vjeç... Nuk mora tjetër grua... S'kam dashur t'i bija vajzës njerkë... E rrita me kujdesjet e mia... I futa në zemër të gjitha ato ndjenjat e bukura që m'i pranoi shpirti: I ndeza dashurinë për punë, për besë, për nder, për trimëri... Unë ju bëra asaj dhe babë dhe nënë, dhe vëlla dhe motër. Ashtu e rrita, me djersë e për djersë... Pa më pyetni? Për-

se s'ja dhashë dikujt me forcë, përse s'e martova edhe kundër vullnetit të saj? Më bëni fajtor, o gjyques, sa të doni, por unë s'kam mundur të detyroja vajzën time të merrte burrë pa qejf të saj, pas gjithë atyre mësimeve që i ngula në zemër...

DASHI — Pleqtë tanë s'na kanë mësuar të jemi aq zemërbutë. Arbëreshët janë trima dhe brrerisht ja presin fëmijës së vet: Po, ose jo. Këtu të gjej me faj, Prenk.

JAKU — Na trego, Prenk, a ishe në dijeni ti për dashurinë e vajzës?

PRENKA — Përpara se të vinte Zefi, besa, s'kam ditur gjë. Ju e dini se vajzën time e grabiti Aqim Beu. E çlroi Zefi me tre trimat tanë, Zefi s'mundi të vinte me ne. Di vetëm se atë mbrëmje foli me Zefin vetëm dy minuta, por, se ç'foli s'më tha gjë as kurrë nuk e përmendi më Zefin... Tani që erdhi, u ul përpara meje në gjunjë e më tregoi se i kishte dhënë besën Zefit qysh në Brisk...

GJONI — E ti, Prenk Vuka, si e quan ti tani këtë punë të vajzës sate?

PRENKA — Në radhë të parë, ajo është vajza ime... dhe, e dyta, unë s'jam thirrur të gjykoj...

MARKU — Mjaft, mjaft! Na thirr Nitën. (*Prenka del, pas pak vjen Nita*)

PAMJA E DYTE

Të parët dhe Nita veshur me roba femrash.

MARKU — Nita e Prenk Vukës, dil përpara nesh
(*Nita afrohet*) Na trego, Nita e Prenk Vukës,
përse na gënjeve?

DASHI — Pse na gënjeve?

GJONI — Na mashtrove!

JAKU — Na mbarove!

NITA — (*si e hutuar, hesht*).

MARKU — Pse mbete pa fjalë? Pse s'po përgjegjesh?

NITA — (*si e ringjallur*) — Jo, jo, gjykuesit e mi!
Jo! Kërkend s'kam gënjer! Kërkend s'kam
mashtuar, as kam mbaruar... Vetëm kam
dashur të iki... Të iki nga djemtë dhe nga
vajzat; të iki nga katundi dhe nga vetja!
Kam dashur të mbyllëm, të humbas, të
zhdukem... S'kam ditur si! Nuk e kam gjetet
udhën e mbarë. Më gjikoni, më preni,
më vritni, por mos grumbulloni aso shpif-
jesh, sepse zemra ime s'di për gënjeshtra e
mashtime...

MARKU — Nita e Prenk Vukës, a kërkove vetë të
të shpallim mashkull?

NITA — Po, kërkova.

GJONI — A të detyroi kush të shpallesh mashkull?

NITA — (*pas nië pushimi të shkurtër*). Po. Më de-
tyroi! (*Të gjithë mbeten të habitur*).

GJONI — C'po thua?

DASHI — C'po thua?

NITA — Të vërtetën them!

JAKU — E si tashti kështu, ndërsa atëhere...

MARKU — (*pleqve*). E shikoni? (*Nitës*) Na i trego, pra, të gjitha!

NITA — O, gjykues, mos u çuditni, po t'ju thoshja prapë se kurrkush nuk më ka detyruar të shpallem mashkull, por gjithmonë diçka më detyroi të fshihem pas petkave të mashku-llit... Më dëgjoni, ju lutem, e pastaj bëni ashtu, si t'ju thotë zemra e shpirti.

Pak më parë ju thashë se kam dashur të ikja... Të ikja nga djemtë, nga vajzat, nga vetëvetja... Përse të ikja, kur tre djemtë më të bukur, më të vyer po më kërkonin përgrua?... Unë s'munda të zgjidhja asnjerin... Këta pritën, duke pasur shpresë se mund të ndërroja mendimin... Vajzave, nga ana tjetër, zuri t'u ndizej flaka e armiqësisë, sepse nuk zgjodha njërin prej tyre dhe të tjerët të mbeteshin të lirë, për t'ju kthyer vajzave të tjera...

E pse unë nuk mora, nuk zgjodha asnjerin? Tri ditë para se të më grabisnin, më hapi zemrën Zefi i Ucit... të cilin qyshkur ma kishte lakmuar zemra... Më shpëtoi nga duart e Aqim beut... Kur u larguan nga Brisku... (*duke qarë*) Ai s'mundi të vinte me ne pa babën e vet. I dhashë besën se do ta prisja... gjer sa të vinte... O, gjer në vdekje... Më fali medaljonin e së ndjerrës nënë... Ma dha besën se do të vinte... ose vdekjen... Tre vjet e prita... Tre vjet përnatë e thirra, duke puthur medaljonin... Sytë e mi s'panë kërkend, veç Zefin... Zemra ime s'më pëlqeu kërkend, veç Zefin... Më parë do të kisha pranuar vdekjen, se sa të

ndahesha nga dashuria e zemrës sime...

Ja, o gjykues, kjo më detyroi, kjo më dhunoi të shpallem mashkull.

MARKU — Ti mund të prisje kë të doje dhe s'ishte nevoja të shpalleshe mashkull!

GJONI — Po të vesh në lojë pushtetin...

DASHI — E po të na mashtrosh ne...

JAKU — Dhe zakonet tona...

PRIFTI — Dhe kishën e shenjtë!

NITA — (*e dëshpëruar*) S'dita më mirë të fshihesha, të mbrohesha dhe të ruaja dashurinë e zemrës sime... Nuk e kam gjetur udhën më të mirë...

MARKU — Po, mirë. Gjer këtu as nuk ka gabime të rënda. Por pas kësaj na i hape plagën...

GJONI — Dhe gënjeve katundin...

DASHI — Dhe nxive faqen...

JAKU — Na preve erzin...

PRIFTI — Dhe hodhe pas krahësh kishën...

NITA — O, zot i madh! — Kur erdhi Zefi... S'kam mundur më të duroja... M'u çel zemra... M'u gëzua shpirti... M'u hap dashuria... I zhvesha rrobat e mashkullit... Ju afrova zemrës së Zefit... dhe, ju, o gjykues, më bëni fajtore për këtë... Më bëni me faj, pra, se këtë dashuri s'ma hiqni nga zemra, por me zemër bashkë!... E ju, gjykoni!...

MARKU — (*i zemëruar*) — Mjaft! Mund të ikësh!...

NITA — (*duke dalë, si e vrarë*) — Zef, për ty, Zef!
(*Ikën*)

MARKU — Na thërrisni Zefin e Ucit!

PAMJA E TRETE

Të parët pa Nitën. Zefi i Ucit veshur me rroba fshatare.

ZEFI — Urdhëroni, gjykues!

MARKU — Ti, Zef i Ucit, je përzier në këtë punë të ndyrë... Na thuaj, ç'di ti!

ZEFI — Më fal, Mark Uci, por kjo punë, në mendon për dashurinë time e të Nitës, jo vetëm që nuk është e ndyrë, por është e dlrë si dielli dhe e pastër si qielli!...

MARKU — Mirë, mirë? Po na trego, kur, ku e si ka filluar?

ZEFI — S'kam ç'të fsheh... Le ta dijë gjithë bota e qielli! Kur — kam qenë i vogël, me Nitën jam rritur, me Nitën kam luajtur, me Nitën jam shoqëruar, kështu që s'di ikur e si më ka hyrë në zemër. Tri ditë para se ta grabiste Aqim Beu, mora guximin dhe i thashë sejeta ime ishte e lidhur me jetën e saj... O, ditë e bekuar! O, sa e madhërishme ditë! Atë ditë, pra, zemra e saj e pëlqeu dashurinë e zemrës sime...

MARKU — Ngadalë, ngadalë! Mos fluturo. Na trego, pse s'erdhe me ne kur ikém nga Brisku?

ZEFI — Thashë se dita më e bukur e jetës sime qe ajo, kur Nita e pranoi dashurimë time. Por ditë më e zezë, më e mjerë qe ajo, kur s'munda të vij me ju, kur ju ikët pa mua. Po më

pyet përse nuk erdha me ju? (*Me dhëmbje të madhe*): Baba im, atë ditë herët, shkoi në Shestan... për të mbledhur paret për bagëtinë që kishte dhënë aty... Nuk u kthye... Si mund të ikja pa babën... Ju ikët... Iku edhe Nita... me zemrën time... dhe me medaljonin e nënës sime... që ja fala për kujtim. Atë mbrëmje i dhamë njëri-tjetrit dorën dhe besën... të prisnim njëri-tjetrin, ose të vdisnim. Kështu... ajo... me babën iku... dhe unë... duke pritur babën... mbeta! E shihni, pra, pse s'erdha?

MARKU — Po, mirë. Tani erdhe. Si ndodhi që erdhe tashti?

ZEFI — Po, tani erdha. Plot mbas tre vjetësh erdha. Erdha mbas shumë vështirësish e hallesh që më ndoqën... Shkurt qe kështu. Të nesërmen, pas ikjes suaj erdhën asqerët me Aqim Beun në krye dhe rrethuan katundin... Pleqtë u treguan se ju kishit ikur... Ju rrëzuan shtëpitë dhe mblodhën tatim të madh, kapën një numër të madh të rinjsh për luftë në Persi... Unë shkova në Shestan të kérkoja babën... E gjeta të... vdekur... E kishin kapur edhe atë për luftë... U përpooq të ikte... e vranë... Pastaj, më kapën edhe mua dhe më çuan ushtar në Persi...

JAKU — (*e ndërprejt*) — A mundesh ti, Zef, t'i biesh shkurt?

ZEFI — Po, gati jam. Dy vjet e gjysmë luftova për turkun, por turku qe i shtypur... Me disa të tjerrë e gjeta mënyrën për të ikur... Pas tre muajsh u gjenda prapë në Brisk... E shita

gjithë gjénë e babës... Në Kotorr bleva një palë petka zotnijsh dhe nga Kotorri, pa shumë pengime, erdha këtu... Erdha për të shpërbyler dy besa të dhëna: besën që ju dha baba se do të vinte me ju dhe besën që unë i dhashë Nitës... Erdha, pra, t'i kérkoj Prenk Vukës, t'ju kérkoj juve, pleqve tanë, të më jepni Nitën për grua...

MARKU — Duke të dëgjuar Zef, mendoj se edhe pleqtë janë në të njëjtin mendim me mua, — nuk po të gjej me faj në punën e ndyrë që na bëri Nita...

GJONI — Na gënjeu ne dhe zotërinjtë...

DASHI — E koriti veten dhe katundin...

JAKU — I mashtroi tiparet e zakonet tonas...

PRIFTI — Edhe kishën e shenjtë katolike e gënjeu..

ZEFI — Jo, jo, pleq! Jo! Jo, gjyques. Asnjë grimië ndyrësi s'ka pastërtia e shpirtit të saj! Nita është e dëlirë si syri... si dielli... si engjëlli! Nita e ka ruajtur pastërtinë e zemrës së vet... Ajo e ka mbajtur besën e dhënë dhe dashurinë e thjeshtë!... Nita s'rren! Nita s'gënjen! Nita nuk mashtron!

MARKU — Na mjafton, Zef, ma mjafton! Të dëgjuam, tashti shko!

ZEFI — Ika, ika. Por, o pleq, dijeni: mbarojeni si të doni punën e Nitës, Nita është imja dhe imja ka për të mbetur. As ju, as kurkush nuk ma hiqni dot nga zemra, as nga krahët e mi. Gjykon si të doni, por unë me të jam e me të do të jetoj, ose vdes!.. (Del)

PAMJA E KATËRT

Të parët pa Zefin

MARKU — (*pas një çast heshtjeje*): A ka kush ende ndonjë gjë për të thënë?

ITHA — Unë dëshiroja të them diçka:

MARKU — Folë, po qe e shkurtër!

ITHA — Atë mbrëmje, para se të iknim nga Brisku, shkova të vizitoja disa familje... Kur ju afrova shtëpisë së Prenk Vukës, e pashë Nitën në... gjoks të Zefit...

MARKU — Atëhere? Ç'do të thuash me këtë?

ITHA — Dua të them... dua të them, se Zefi dhe Nita janë dashruar edhe para...

MARKU — Mjaft, mjaft! Ajo nuk e lehtëson hiç punën.

ITHA — Mërk, Nita të shpëtoi fëmijën!...

MARKU — Itha! Ajo punë s'hyn tanë këtu! Mjaft dhe largohu tashti! (*Itha tërhiqet*): A ka edhe ndonjë tjetër që e do fjalën?

MIMQI — (*del përpara*): Unë, gjyques, unë... unë jap edhe shpirtin për Nitën! Nita është e drejtë! Nita s'është fajtore. Zemra e saj është e butë, e mirë, e dëlirë! Nita s'di të rrejë, s'di të gënjejë, të mashtrojë... Kur fati s'ma dha mua... (*fillon të gjëmojë*) jepjani Zefit... Bashkon dy zemra... të cilat... duhen shumë!

GJONI — Trimat nuk gjëmojnë!

MIMQI — (*i ofenduar*) — Kush i tha këto fjalë?... Kush tha se s'jam trim?... Kush do ta njoħe thikën ose koburen time? Kush më preku në zemër?!... Kush është që do t'ja pi gjakun?...

Kush do që t'ja heq mushkërinë nga gjoksi?
(Qetësi e madhe).

LUKA — (*pas një heshtjeje*) — Mimq, ti je trim i njohur. Kush i nxori ato fjalë nuk ka rëndësi. Por, kush i tha, i tha, nuk mendoi të të ulte! Unë haptazi po them: trimat e kanë zemrën të butë!...

MJMQI — (*pak i zbutur*) Të faleminderit, Luka-petani! Trim je dhe i urtë je!... Edhe një herë të falenderoj, se s'është këtu fusha e luftës... Kush do të ndeshet me mua, le të më thërrasë jashtë! (*Ikën*)

PAMJA E PESTË

Të parët pa Mimqin

MARKU — (*pas një pushimi të shkurtër*) Tashti, pasi e shoshitëm këtë punë, pasi na u bënë të njohura të gjitha, na duhet, o gjykues, të vendosim, të presim dhe t'i japim fundin. Tashti, kur e dimë si ndodhi, si erdhi puna, jam i mendimit se Prenk Vuka s'ka faj këtu, veçse nuk e preu martesën e vajzës edhe pa pëlqimin e saj. Zefin e Ucit s'e gjej aspak fajtor, veç, duke ditur se vajza u shpall mashkull, nuk u largua prej saj. Për Nitën, vajzën e Prenk Vukës, nuk desha të jepja mendim, pa dëgjuar dhe mendimet tuaja, o gjykues... Kam thënë.

GJONI — Ti, Mark Uci, e the fjalën tënde. Unë bash-

Çohem me mendimin tënd sa për Prenkën, aq edhe për Zefin. Por, për Nitën?... Ne kemi qenë të ikurit... Zotnia e pushteti i këtyre na prunë këtu, na falën shtëpitë, tokën dhe ushqimin... I lutëm të na pranonin shpalljen mashkull të vajzës, sipas zakoneve tona. Po, na pranuan... Përpara guvernotit tonë, zotni Kristofolit, e shpallëm Nitën mashkull, e kjo, pas tre muajsh, e theu, e rrëzoit caktimin tonë, e poshtëroi pranimin e pushtetit dhe na nxiu faqen përpara zotërinjve tanë... Unë s'mundem, pra, ndryshe, vegse ta gjej fajtore!... Shumë fajtore! Ky është mendimi im!

DASHI — Ti, Gjon, e pe këtë çështje vetëm nga një anë dhe mirë the. Zakonet tona të vjetra thonë: Kur vajza s'do të martohet... mund të shpallet mashkull, por nuik thonë, se kjo vajzë mund të kthehet prapë në femër, sepse kështu mund të vihen zakonet në lodër dhe; me to, të luhet si macja më minë... Kështu dhe Nita deshi të luante... t'i thyente,... t'i bënte asgjë! Dhe, për këtë, vajza e Prenk Vukës është fajtore! Me faj, pra, me faj! Kështu mendoj unë.

JAKU — Me rëndësi të madhe, o gjykues, është edhe një çështje tjetër. Mirë. Neve, pleqve, na duhet të gjejmë fundin e një çështjeje dhe ta gjykojmë... Sipas lutjes së vajzës, ne, pleqtë, ne, gjykuesit, e vendosëm, i dhamë fund, le të shpallet vajza mashkull!... Por, le t'ju pyes, o gjykues, çfarë dreqi vendosëm, kur aprovim tonë e theu vetë ai që na lutit aprovoni?

Për çfarë dreqi, po ju pyes, o gjykues, pér çfarë dreqi jemi ne?!... Eshtë fajtore, pra, edhe pér përbuzjen e gjykuesve! Edhe unë e thashë timen...

MARKU — Mirë e zgjidhët këtë nen, o pleq!... Në qoftë se s'ka ndonjë tjetër, pér të thënë gjë, mund të përfundojmë këtë punë të vësh-tirë...

PRIFTI — Më duket, o pleq, se gati-gati e harruat fajin më të rëndë të Nitës. Desha të them, fajin kundrejt kishës sonë të shenjtë kato-like... Kisha jonë e shenjtë ka qenë e para, që u muarr me shpalljen e Nitës mashkull. Kisha jonë e shenjtë, barabar me pushtetin, me zakonet dhe, me ju bashkë, e caktoi shpalljen mashkull të vajzës. Në librat të kishës së shenjtë është e shënuar kjo ve-pér, në fund të së cilës unë shënova: «Ashtu qoftë!»... Kjo sjellje faqezezë e vajzës e mashtroi, e tradhëtoi edhe kishën e shenjtë katolike, edhe fenë tonë të shenjtë... Pér këtë arësyё edhe unë e bëj vajzën e Prenk Vukës....

ITHA — (*si e marrë, e ndërpret*) — O! O, zot i madh, gjer ku e sollën!... O, zot, gjer ku shkuani! (*e tërbuar*): Ju!... Ju, pa zemër e pa shpirt!... Ju! Ju, pa ndjenja e pa mëshirë! Ju, që e keni humbur zemrën!... Ju, ju s'dini, s'dini ç'do të thotë dashuri e gruas!... Ju, ju, gjy-kues!... Ju! Ju, të shenjtë!... O, o, (*Ikën duke qarë. Pas saj edhe Cana*).

PAMJA E GJASHTË

Të parët pa Ithën e Canën

LUKA — Më falni, o pleq, le të them edhe unë disa fjalë...

MARKU — Urdhëro, Luk, urdhëro!

LUKA — Para tre vjetësh u shkulëm nga toka jonë e vjetër, u ndamë nga varret e pleqve tanë. U shkëputëm nga trupi i popullit tonë dhe ikëm... Tani jemi këtu, në tokë të re, në tokë, për ne të njomë, ku tiparet dhe zakonet tona të vjetra nuk mund të mbahen aq fort dhe rreptë si në tokën e vjetër... Kur bima e ndërron tokën e vet, duke u rritur, i ndërron si gjethet, ashtu edhe frutin. Ashtu edhe ne, më mirë të rinxjtë tanë, duhet dalëngadalë t'i ndërrojmë veset e zakonet tona sipas rrëthanave, sipas kushteve të jetës sonë në rrëthana të reja, ku po gjendemi...

MARKU — Aferim, Luk, urtësisë tënde, por këto fjalët e tua s'po m'i merr mendja mirë....

DASHI — Besa, as unë s'po i kuptoj...

JAKU — Mua po më duken se s'kanë lidhje me gjykimin tonë....

GJONI — As unë nuk i kam të kthjellta, por do ta pyesim Lukën të na i shpjegojë...

LUKA — O pleq, desha të them se ne s'jemi në Arberi të turkut, në krahinë të Shkodrës! Ne jemi tani në Dalmaci, këtu buzë Zadrës... (*Pleqtë pranojnë me shenja*) Po, mirë. Ju të gjithë, o pleq, e gjetët vajzën e Prenk Vukës me faj!... Fajtorë se ka gënjer push-

tetin tonë të ri, fajtore se ka mashtruar zakonin tonë të vjetër, fajtore se ka nxirë vreten e katundin, fajtore se ju gënjeu juve, gjykuesit, fajtore për këtë, fajtore për atë, kështu që vajza e Prenk Vukës është gënjeshtare, mashtruese, faqezezë, e pandershme, e poshtër, e me bishtra gjithfarë sojesh... Kështu që tani duhet ta mbysim, ta vrasim, ta lidhim pas bishtit të qeve.

MARKU — (Po, fajtore është! Si s'është fajtore?)

GJONI — Po, fajtore! Na gënjeu ne dhe pushtetin...

JAKU — Fajtore! Na koriti ne dhe katundin!

DASHI — Fajtore, pra. Dhe ti po thua...

LUKA — Unë mblodha të gjitha ato që thatë ju!...

PRIFTI — Ke harruar, Luk, të thuash: tradhëtare e kishës së shenjtë!...

LUKA — (*duke parë priftin me bisht të syrit*)... dhe këtë që thotë dhe prifti ynë — i shenjtë... (*Roza, duke vënë dorën në zemër, ikën*).

PAMJA E SHTATE

Të parët pa Rozën

LUKA — (*vazhdon*) — Por, o pleq, në gjykimin tuaj, a e keni dëgjuar zërin e popullit?... Zërin e Ithës?... Zërin e Mimqit?... Përse, o pleq, mendimi im dhe zemra ime u bashkuani me mendimin dhe me zemrën e tyre!... (*Pleqtë duan të protestojnë, por Luka i ndërpert*) Më falni, më falni të flas! Nuk kam mbaruar akoma!

Përpara shpalljes së vajzës mashkull, ju më vutë detyrë të flisja me zotnijtë. Kur u tregova se, sipas zakoneve tonë, ju deshët të shpallnit mashkull një vajzë, ata qeshën, sa s'dita ku të futesha... Më thanë: «Si mund të bëhet delja dash?... T'i vësh brirët në kokë?... O, po të ketë brirët s'ka për t'i vajtur dashi pas?... Por, kur duan... le ta bëjnë. Mos thonë: po na këpusin zakonet!»

MARKU — Pse s'na i tregove këtë, para se ta shpallnim vajzën?...

LUKA — S'ju tregova, se s'qe nevoja t'ju tregoja... Po ju tregoj tashti, që ta dini se, si zotnijtë ashtu edhe pushteti nuik janë të gënjer... (*Pleqtë bëjnë shenja dyshimi*) Tani del pyetja: Pse deshi Nita të shpalley mashkull? Zemra e saj ka qenë e zënë qysh në Brisk, kur i dha djalit besën... Djali s'mundi të vinte dot me të, me ne... Vajza për natë qan për të, i puth medaljonin, lutet për të, forcon besën e dhënë dhe pret!... Çfarë zemre! Çfarë bese! Çfarë dashurie!... Këtu po e lusin, po e kërkojnë, po e turbullojnë djemtë, këtu e kanë marrë mëri vajzat!... Këto turbullime, kjo mëri e shtyn të mjerën vajzë të shpallet mashkull: ta linin djemtë në qetësi, të ishin të kënaqura vajzat, të shtrihej qetësia në katund!... Sa e mençur, sa e kuptuar, sa e urtë dhe sa trimë!... Dhe ju, pleq, për këtë përfunduat: Fajtore! Fajtore!... Më lejoni t'ju pyes: Kë mbyti? Kë vrau? Kujt ja nxiu faqen? Po thoni: I mashtroi zakonet!... Dhe unë them!

Më mirë të mos qenë të tilla zakone!... Por, gjithsesi, ajo nuk i mashtroi nuk gë-njeu! Ajo, e mjera, u fsheh pas tyre, që të mund të mbante besën e dhënë!... Dhe, për këtë, nuk ka faj!... (*Pleqtë shikojnë njëri-tjetrin*).

PRIFTI — Uh, Luka, unë s'mund të bashkohem me mendimin tënd... Si nuk është fajtore, kur e kemi shpallur mashkull para zotit dhe ajo e theu atë që lidhi kisha e shenjtë!...

LUKA — Ngadalë, uratë! Kur ndokush bën faj, atë-here kisha e shenjtë e ndjen, ja fal fajt e mëkatet... Për çudi të madhe, si u ngut prifti ynë: «Fajtore!» Asgjë më pak, por tradhëtare e kishës!... E zeza, e bëtë magjype, e kthyet në çifute, e shpallët luterane!... Priftërinjtë duhet të shtrinë paqen, të vendosin qetësinë, të kapin dashurinë dhe të bashkojnë zemrat që duhen... e jo të bëjnë fajtor, siç ndodh në këtë rast, ku u bashkuan urtësia dhe besa me dashuri... Prifti i pari e pranoi shpalljen e vajzës mashkull... Mirë, në se vjen të shtrijë paqen ndërmjet të rinjve. Mirë, po them, në se i jep fund për të mirë, por keq e më keq, nëqoftëse shkon pas zakoneve të vjetra, kundër të cilave edhe vetë duhet të luftojë, sepse gjithshka që është kundër natyrës, njëkohësisht është edhe kundër kishës... Unë s'jam i mësuar, por kështu ma pret mendja...

Kam folur shumë, jashtë zakonit tim, por desha t'ju bëj të ditur, se gjykimi juaj nuk është i drejtë dhe se duhet ta ndreqni dhe ta shpalimi vajzën e Prenk Vukës të

dlirë ndaj akuzave, fajeve që i keni ngarkuar dhe ta çlironi nga të gjitha.

PRENKA — (*i gëzuar*) — Aferim, Luka-petani, aferim!... I lumtur qofsh!

MARKU — Për besë, Luka, fjala jote më bëri të dyshoj në drejtësinë e gjykimit tonë...

GJONI — Megjithatë, si të thoshim tashti...?

DASHI — E si, atëhere... zakonet tonë?...

JAKU — Përfundimin akoma nuk e kemi thënë...

PRIFTI — U bë! Mirë... Le të rrëfehet Nita në kishë...

PRENKA — Të rrëfehet, le të rrëfehet!... Çlirojeni prej fajit!...

(*Të gjithë ata që qenë aty, largohen ngadalë të gëzuar*).

PAMJA E TETË

Pleqtë, prifti, Luka e Prenka

MARKU — Besa, ja kjo është femra e fundit që shpallëm mashkull!

JAKU — Na hape sytë, Luka, aferim...

GJONI — Po, po. — Zakonet tonë të vjetra do të humbasin, do të zhduken, por edhe ne me to!...

DASHI — Mirë the. Rembi i këputur nga lisi thahet! Ashtu edhe ne...

PRIFTI — Gjithshka mund të humbasë, mund të zhduket. por kisha jonë e shenjtë kurrë! (*Diku larg ndihet një krismë kobureje*).

LUKA — (*duke dëgjuar*)... Krisi koburja!... Hm (*Priftit*): Mos u ngut prapë, uratë. Njeriu lind dhe vdes... Lisat mbijnë, rriten e zhduken... Gjithshka që lind ka dhe mbarimin e vet...
PRIFTI — (*si i frikësuar bën kryq*): Në emër të atit, të birit, të shpirtit të shenjtë!

PAMJA E NËNTË

Në parët, Itha, burra e gra

ITHA — (*hipën shpejt, pa frysme, duke qarë dhe pas saj edhe të tjerë*): U vra!... U... vra!
LUKA — (*duke e parandjerë*): Kush?... Kush u vra?
ITHA — (*si nga lart*): U vra lulja e katundit!...
PLEQTE — (*pa durim*) Folë! Folë!
ITHA — (*si nga lart*) Nita!... Nita e... Prenk Vukës!
PRENKA — (*duke kapur me duar gjoksin*): O!... Nita, zogu i tatës!
ZERA — U vra?... U vra?...
LUKA — Ku?... Si?...
ITHA — (*si nga lart*)... Me koburen... e guvernatorit!

PAMJA E DHJETË

Të parët, Cana, pas saj Roza e vajza të tjera

CANA — (*pa frysme e duke qarë*). U vra!... U vra!...
PRENKA — (*me zë të dhimbshëm*) — Nita, syri i tatës!...

ZERA — O!... E mjera!... E shkreta!... E zeza!...

LUKA — Kush di tē na tregojë si ndodhi?

ITHA — (*si nga lart*) — Nuk e di... Nuk e di... Kur dëgjova koburen... vrapova tē shikoja... O, kur ç'të shikoja... Gjithë gjak... e shtrirë në oborr... pranë saj koburja... në njérën dorë medaljoni... O, o! (*gratë e vajzat qajnë*).

CANA — (*si nga lart*)... Dy-tri minuta... para se tē vritej... m'u lut ta lija vetëm... Më tha: Cana, tē gjithë më kanë gjykuar...» O, Nita!... Nita!

PAMJA E NJËMBËDHJETË

Të parët, Mimqi e disa djem

MIMQI — (*duke hipur*) E vratë!... E vratë, ju vraftë Krishti!...

PRIFTI — Mos lëndo zotin, Mimq!...

MIMQI — (*plot hidhërim*): Uratë, mos më prek më, uratë, se mund ta harroj urdhërin e shenjtë që ke, se...

PAMJA E DYMËDHJETË

Të parët dhe Zefi

ZEFI — (*duke u ngjitur, me hidhërim të madh*): Ma vratë!... Ma vratë!... Ja pitë gjakun e pastër,

ju gjaksorë!... A jeni ngopur... Në qoftë se s'ju mjafton... dhe kërkoni më, s'kam! (*e heq koburen*) Ja edhe gjaku im! (*ngre koburen*).

PRENKA — (*Ja kap shpejt dorën dhe ja çon mbi krye e aty shkrepet*) Jo! Jo, biro!... Mjaft gjak ka... s'ka nevojë!... (*E merr në gjoks. Zefit i bie koburja nga dora*): Kështu... i bashkojmë dhëmbjet... për... Nitën!... (*Pasi hesht pak*) — Hajdeni tani... të shikojmë... ti nusen tënde... dhe unë... Nitën time!

ZEFI — (*Duke dalë me Prenkën*) — Nita!... Nita! (*Pas tyre dalin edhe të tjerët*).

F U N D

Redaktor: *Pandeli Koçi*

Kopertina nga *Safet Marko*

Tirazhi 4000 kopje Format 70x100/32 Stash: 2204-73

Shtyp. Drejtoria Qendrore Poligrafike
Shtypshkronja «8 NENTORI» — Tiranë, 1973